



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 26

Tiranë – E enjte, 18 shkurt 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11965, datë 12.2.2021	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	3547
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1177, datë 24.12.2020	Për një ndryshim në vendimin nr. 389, datë 13.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”.....	3547
Udhëzim i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 1, datë 10.2.2021	Për rregullat e përdorimit dhe të gëzimit të shërbimeve që ofron zona e mbrojtur mjedisore dhe pagimin e çmimeve për to.....	3548
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 2, datë 2.2.2021	Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të maturës shtetërore profesionale 2021.....	3553
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 81, datë 12.2.2021	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë, Sllovakisë, Hungarisë, Gjermanisë, Ukrainës, Izraelit, Çekisë, Rumanisë, Bullgarisë, Belgjikës, Kroacisë, Danimarkës, Francës, Holandës, Lituanisë dhe Italisë.....	3555
Vendim i Këshillit të Lartë të Arkivave nr. 2, datë 8.2.2021	Për një shtesë në normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.....	3557
Vendim i Këshillit të Lartë të Arkivave nr. 3, datë 8.2.2021	Për miratimin e standardeve të kutive dhe dosjeve, për ruajtje të përhershme, si dhe listës së institucioneve dhe tipologjisë e dokumenteve të institucioneve që janë të detyruara të zbatojnë këto standarde.....	3558
Urdhër i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave nr. 136, datë 12.1.2021	Për delegim kompetencash.....	3565
Vendim i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr. 3, datë 11.2.2021	Për anëtarësimin e shoqërisë së kursim-kreditit “Fast Credit Albania” në skemën e sigurimit të depozitave dhe dhënien e certifikatës për sigurimin e depozitave.....	3565

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 3, datë 15.1.2021	Mbi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. për shtyrjen e afatit të marrjes në shqyrtim të kërkesës, për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 169, datë 3.11.2020, “Për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020 dhe atë të përditësuar, dhjetëvjeçar, 2015–2025, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST” sh.a.....	3566
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 4, datë 15.1.2021	Mbi kërkesën e FSHU sh.a. për disa ndryshime në “Kontratën tip për shitblerjen e energjisë elektrike, ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal/FSHU sh.a, për furnizimin e klientëve fundorë”	3567
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 5, datë 15.1.2021	Mbi anulimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 226, datë 15.12.2020, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 209, seria T13, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Shutina Energji’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 1.10.2013.....	3570
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 6, datë 15.1.2021	Mbi kërkesën e shoqërisë Albgaz për shtyrjen e afateve të përcaktuara në rregulloren e kriterëve standarde dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 100/2019.....	3571
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 8, datë 20.1.2021	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 443, seria P19, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “SANG 1” sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 31.5.2019, të ndryshuar.....	3573
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 9, datë 20.1.2021	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 447, seria T19, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 26.6.2019.....	3575
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 11 , datë 20.1.2021	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “GERTP” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	3576
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 12, datë 20.1.2021	Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k., për transferim të aseteve (vendosje hipoteke) në favor të “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a.....	3577
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 17, datë 20.1.2021	Mbi përfundimin e procedurës administrative të filluar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 230, datë 15.12.2020, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 415, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Blac Energy’ sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 157, datë 9.7.2018”	3578

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 18, datë 20.1.2021	Mbi përfundimin e procedurës administrative të filluar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 15.12.2020 “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 369, seria TGN17, për veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror, dhënë shoqërisë “C.G.C” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 16.5.2017.....	3580
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 21, datë 25.1.2021	Mbi licencimin e shoqërisë “Greentech Energy Systems” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Pishat”, me kapacitet të instaluar 1991 kw.....	3581
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 22, datë 25.1.2021	Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 183, datë 13.11.2020, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Greentech Energy Systems’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”.....	3583
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 23, datë 25.1.2021	Mbi licencimin e shoqërisë “ES 2019” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	3584
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 24, datë 25.1.2021	Mbi kërkesën e OSSH sh.a., lidhur me përdorimin e vlerave zëvendësuese të konsumit të energjisë elektrike përgjatë periudhës së zbatimit të masave parandaluese ndaj COVID-19.....	3585
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 25, datë 25.1.2021	Mbi aplikimin e shoqërisë OSSH sh.a. për miratimin e tarifës së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, në nivel tensioni, për vitin 2021.....	3587
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 26, datë 25.1.2021	Mbi aplikimin e shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. për miratimin e çmimit të shërbimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike, për vitin 2021.....	3589
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Bardhul Metushi.....	3591

**DEKRET**

Nr. 11965, datë 12.2.2021

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe të nenit 93, të Kushtetutës, si dhe të nenit 23, pika 1, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Edmond Myslim Gjyzeli
2. Ines Thoma Kristo
3. Frenklin Kujtim Skuçi
4. Panajot Arben Beluli
5. Brixhilda Fatmir Velaj
6. Byrhan Smajl Krymbi
7. Arlinda Ridvan Butja
8. Migena Muhamed Ostermann (Fyshku)
9. Elvidys Ramiz Idrizi
10. Drita Halil Vorpsi (Seci)
11. Gentian Nikolla Mitrushi
12. Alba Mahmut Xhani
13. Teuta Rexhep Qelibari (Sejdo)
14. Artur Osman Veliu
15. Arjola Selim Krymbi (Velaj)
16. Eglantina Kozma Kuqi (Çombashi/Combashi)
17. Kelvi Altin Kuqi
18. Esmeralda Brahim Kaurschill-Demo (Demo)
19. Julinda Nevruz Bajri (Kalaci)
20. Ajdita Altin Bajri
21. Andris Durim Domi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

VENDIM

Nr. 1177, datë 24.12.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 389, DATË 13.5.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
LISTËS DHE TË TARIFAVE TË
SHËRBIMEVE KADASTRALE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 63, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në aneksin bashkëlidhur vendimit nr. 389, datë 13.5.2020, të Këshillit të Ministrave, shtohen shërbimet sipas aneksit nr. 1/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**



LISTA E SHËRBIMEVE TË OFRUARA NGA AGJENCIA SHETETËRORE E KADASTRËS

SHITESË

Nr.	Lloji i shërbimit	Tarifa (lekë)	Aplikimi ose jo i kamatëvonesës (10% e tarifës/ditë vonesë, por jo më shumë se 300 000 lekë
66	Lëshim ekstrakti informues nga sistemi i pasurive të paluajtshme	1100	JO
66/1	Lëshim ekstrakti informues nga sistemi i pasurive të paluajtshme për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për projektin “Nafta për bujqësinë”	1100	JO

UDHËZIM
Nr. 1, datë 10.2.2021

**PËR RREGULLAT E PËRDORIMIT
DHE TË GËZIMIT TË SHËRBIMEVE QË
OFRON ZONA E MBROJTUR
MJEDISORE DHE PAGIMIN E ÇMIMEVE
PËR TO**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 57, të ligjit nr. 81/2017, datë 4.5.2017, “Për zonat e mbrojtura”,

UDHËZOJ:

1. Miratimin e rregullave për përdorimin dhe gëzimin e shërbimeve që ofrohen në zonat e mbrojtura mjedisore nëpërmjet kryerjes së veprimtarive ekonomike, shoqërore, turistike, kërkimore-shkencore dhe çdo lloj veprimtarie tjetër të lejuara nga legjislacioni në fuqi për zonat e mbrojtura dhe në përputhje me planet e menaxhimit respektive të këtyre zonave.

2. Shërbimet që ofron zona e mbrojtur mjedisore përdoren nëpërmjet ushtrimit të veprimtarive të përcaktuara më lart, nëse ato përmbushin rregullat e mëposhtme:

a) të jenë të parashikuara në planin e menaxhimit të zonës dhe në rast se nuk është miratuar plani i menaxhimit, deri në miratimin e tij, zbatohen parashikimet ligjore të përcaktuara në kategorinë, shkallën e mbrojtjes dhe/ose zonimin,

sipas ligjit “Për zonat e mbrojtura” dhe legjislacionit në fuqi;

b) të jetë marrë më parë leja e mjedisit për ato aktivitete të cilat kërkohet leja në përputhje me legjislacionin në fuqi për lejet e mjedisit;

c) të jenë pajisur me miratimin paraprak të organit brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të të cilit është veprimtaria;

d) të jenë në harmoni me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe integritetit për zonat e mbrojtura;

e) të jenë në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

3. Afati i përdorimit/gëzimit të shërbimeve të lejuara të jetë deri në 10 vjet, në përputhje me planin e menaxhimit, me të drejtë rinovimi. Për kontratat me afat 10-vjeçar merret miratimi paraprak nga ministria. Afati rishikohet çdo 5 vjet nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) dhe Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura (AdZM). Në rastet kur plani i menaxhimit për veprimtaritë e lejuara parashikon një afat tjetër zbatohen afatet e përcaktuara në planin e menaxhimit, por në asnjë rast jo më shumë se 10 vjet.

4. Veprimtaritë e lejuara në zonat e mbrojtura duhet:

a) të sjellin përmirësime të dukshme në ekosistem dhe habitat, në mbarëshkrimin e florës dhe faunës që ndodhen në këto sipërfaqe;

b) të realizojnë investime që përmirësojnë treguesit biologjikë, mjedisorë e turistikë dhe të infrastrukturës së zonës;



c) të mos cenojnë vlerat natyrore, mjedisore, turistike dhe funksionet e tyre;

d) të jenë në përputhje me planin e përgjithshëm vendor dhe/ose planin e detajuar vendor për zonën, në rast se ato ekzistojnë.

5. Në zonat e mbrojtura mjedisore ushtrohen veprimtari ekonomike, shoqërore, turistike, kërkimore-shkencore, bazuar në kategorinë e zonës së mbrojtur, shkallën e mbrojtjes sipas zonimit dhe për aq sa e lejon legjislacioni në fuqi për zonat e mbrojtura, si dhe planet e menaxhimit të këtyre zonave. Veprimtaritë që mund të ushtrohen në zonat e mbrojtura mjedisore, por pa u kufizuar në to, janë si vijon:

5.1 Veprimtaritë që lejohen të ushtrohen në zonat e mbrojtura mjedisore, për sa përputhen me kategorinë e mbrojtjes së zonës:

a) ndërhyrjet e nevojshme për rigjenerimin dhe shëndetësimin;

b) aktivitete të turizmit të qëndrueshëm, në përputhje me kategorinë dhe shkallën e mbrojtjes së zonës, si dhe struktura në përputhje me përcaktimet e Planit të Menaxhimit në shërbim të aktiviteteve turistike;

c) grumbullimi i bimëve medicinale dhe prodhimeve të dyta, në pyje dhe kullota, në përputhje me kategorinë dhe shkallën e mbrojtjes së zonës;

d) aktivitete rekreative, sportive, kamping, kampera, stacione plazhi eko-turistike;

e) fidanishte të llojeve autoktone/vendase;

f) për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme autoktone/vendase;

g) për mbarështimin e faunës së egër autoktone/vendase;

h) për vendosje koshere bletësh;

i) kundrimi i shpendëve dhe vëzhgimi i faunës se egër;

j) çdo veprimtari tjetër në përputhje me Planin e Menaxhimit;

k) çdo veprimtari tjetër në përputhje me vendimet e Këshillit Kombëtar të Territorit.

5.2 Në zonat e mbrojtura detare, liqenore dhe lumore lejohen të ushtrohen veprimtaritë e mëposhtme, pasi të jenë pajisur me miratimin paraprak:

a) zhytjet dhe turizmi nënujor i qëndrueshëm, me metoda miqësore ndaj mjedisit;

b) lundrimi turistik dhe aktivitete sportive ujore, në përputhje me kategorinë dhe shkallën e mbrojtjes sipas zonimit;

c) peshkimi dhe akuakultura artizanale, në përputhje me kategorinë dhe shkallën e mbrojtjes sipas zonimit;

d) ndërtime infrastrukture ankoruese, miqësore ndaj mjedisit;

e) çdo veprimtari tjetër në përputhje me Planin e Menaxhimit;

f) çdo veprimtari tjetër në përputhje me vendimet e Këshillit Kombëtar të Territorit.

5.3 Ngritja e qendrave të informacionit, këndeve për shitjen e suvenireve dhe produkteve lokale, si dhe menaxhimi i qendrave të informacionit ekzistues në zonat e mbrojtura.

5.4 Veprimtaritë ekonomike, në rastet kur persona fizik/juridik janë të pajisur me leje/licencë nga institucionet përkatëse, të miratuara paraprakisht me akte të tjera ligjore për veprimtaritë e listuara si më poshtë, për sa kohë nuk vijnë në kundërshtim me ligjin në fuqi për zonat e mbrojtura:

a) procedurat në zbatim të ligjeve për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë;

b) procedurat në zbatim të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006, “Për koncesionet”;

c) procedurat në zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”;

d) procedurat në zbatim të ligjit për peshkim dhe akuakulturë;

e) procedurat në zbatim të ligjit për përdorimin e ujërave, kur nuk janë në kundërshtim me ligjin;

f) procedurat në zbatim të ligjit për ndërtim të veprave hidroteknike (për shtrirje tubacionesh dhe ndërtim kanalesh për HEC, kur nuk janë në kundërshtim me ligjin;

g) të ndjekin procedurat në zbatim të ligjit për ndërtimin e antenave të komunikimit radioteleviziv dhe telefonisë celulare;

h) të ndjekin procedurat në zbatim të ligjit për ndërtim të linjave elektrike e kabllave optike, instalimeve të naftës apo gazsjellës, kur nuk janë në kundërshtim me ligjin;

i) të ndjekin procedurat në zbatim të vendimeve të Këshillit Kombëtar të Territorit;

j) të ndjekin procedurat në zbatim të ligjit për ndërtim të kullave për parqet eolike dhe



infrastrukturën ndihmëse, kur nuk janë në kundërshtim me ligjin.

6. Rregullat për dhënien në përdorim/gëzimit të shërbimeve që ofron zona e mbrojtur (ZM) mjedisore

6.1 Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) miraton ushtrimin e veprimtarive dhe lidhjen e kontratave për përdorimin dhe gëzimin e shërbimeve që ofron zona e mbrojtur mjedisore, bazuar në propozimet e paraqitura nga Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdZM-të).

6.2 Sipërfaqet e zonave të mbrojtura dhe infrastruktura mbështetëse ku do të ushtrohen veprimtaritë dhe për të cilat lidhet kontratë shërbimi, sipas përcaktimit të pikës 1, të jenë:

- a) sipërfaqe me pyje;
- b) sipërfaqe me bimësi pyjore;
- c) sipërfaqe kullosore/livadh;
- d) sipërfaqe ujore;
- e) sipërfaqe inproduktive;
- f) sipërfaqet bregdetare/plazhet.

6.3 Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdZM-të), në çdo qark, vlerësojnë shërbimet, veprimtaritë ekonomike të ZM-ve apo infrastrukturën përkatëse, dhe brenda muajit janar të çdo viti dërgojnë për miratim, pranë AKZM-së, listën e veprimtarive që parashikohen të ushtrohen në çdo zonë të mbrojtur, shoqëruar me një relacion, sipas formatit të miratuar nga AKZM-ja, mbi mundësitë e zhvillimit të tyre. Gjatë procesit të vlerësimit për shërbimet, veprimtaritë ekonomike të ZM-ve apo infrastrukturën përkatëse, strukturat përgjegjëse në AdZM të mbajnë parasysh rregullat dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarive në zonat e mbrojtura mjedisore të përcaktuara në këtë udhëzim dhe në legjislacionin në fuqi për zonat e mbrojtura.

6.4 Pas miratimit në parim nga AKZM-ja, të listës së propozuar për veprimtaritë/shërbimet e zonave të mbrojtura dhe infrastrukturën mbështetëse, AdZM-ja përgatit studimin, i cili përmban:

a) sipërfaqen (territorin) e zonës së mbrojtur të shprehur në metër katror (m^2), me kufij të përcaktuar qartë në hartë të shkallës 1:10000 (koordinatat gjeografike, metrike);

b) përdorimin e tokës në sipërfaqen e zonës së mbrojtur të njehsuar (m^2), e cila cakton kategorinë

e zonës së mbrojtur, zonimin e brendshëm, ekonominë pyjore/kullosore, numrin e parcelës, kufizimet natyrore dhe koordinatat, etj.;

c) treguesit identifikues (kadastral) të ngastrave e nënngastrave;

d) karakteristikat biologjike e mjedisore të bimësisë në territor;

e) treguesit tekniko-ekonomik për kullotat e livadhet;

f) treguesit e vlerës për çdo njësi kadastrale të sipërfaqes (territorit) të zonës së mbrojtur, bazuar në vlerën e qirasë për ha/vit, km/vit të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave.

6.5 Pas shqyrtimit të propozimeve, Drejtori i Përgjithshëm i AKZM-së miraton studimin dhe autorizon AdZM-në për pranimin e kërkesave nga personat fizik/juridik, publik ose privat, dhe i publikon ato në faqen zyrtare të AKZM-së. Lista e sipërfaqeve dhe veprimtarive të miratuara afishohen pranë çdo AdZM-je.

6.6 Personat fizik/juridik, publik ose privat, që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari ekonomike në zonat e mbrojtura, mund të paraqesin në çdo kohë kërkesën në formën e propozimit, sipas kërkesave të këtij udhëzimi dhe sipërfaqja e miratuar të përdoret vetëm për ushtrimin e veprimtarive të parashikuara në legjislacionin në fuqi për zonat e mbrojtura.

6.7 Për administrimin e kërkesave AdZM-ja duhet të kryejë:

a) përgatitjen e studimit/raportin tekniko-ekonomik për sipërfaqen e kërkuar, sipas modelit tip të miratuar nga AKZM-ja;

b) paraqitjen pranë drejtorisë përgjegjëse për menaxhimin në AKZM, për shqyrtim dhe miratim të kërkesës, së bashku me studimin tekniko-ekonomik;

c) pas miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm/ AKZM-ja, vazhdohet me procedurat e mëtejshme të miratimit të kërkesës dhe lidhjes së kontratës, sipas rastit.

6.8 Dokumentet që duhet të paraqesin personat fizik dhe juridik, për përdorimin dhe gëzimin e shërbimeve që ofron ZM-ja, janë si më poshtë:

a) kërkesë e aplikuesit së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre;

b) ekstraktin e regjistrimit në institucionin përgjegjës për objektin e veprimtarisë;

c) projektin teknik të hartuar nga specialistë të licencuar, sipas fushës përkatëse në të cilën do të



kryhet veprimtaria, ku të jenë trajtuar të gjitha elementet e nevojshme për shqyrtimin dhe zhvillimin e veprimtarisë ekonomike të kërkuar;

d) hartat, kur është sipërfaqe në përdorim, dhe vërtetim për pronësinë nga institucionet përgjegjëse, kur është territor privat;

e) plan biznesin dhe investimet që do të bëhen; nivelin e punësimit në këtë veprimtari;

f) planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme;

f. lejen mjedisore për aktivitetin që do të ushtrohet, në rast se për ato aktivitete kërkohet leja në përputhje me legjislacionin në fuqi për lejet e mjedisit;

g. miratimin paraprak për ushtrimin e veprimtarisë nga organi brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të të cilit është veprimtaria;

g) NUIS-in dhe vërtetimin nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore;

h) vërtetime nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk është në procese gjyqësore penale që kanë lidhje me aktivitetin që ushtrohet, në rrethin gjyqësor ku pretendon të ushtrojë aktivitetin.

6.9 Për të gjitha veprimtaritë, sipas pikës 5, të këtij udhëzimi, kërkesa dhe dokumentacioni tekniko-ligjor dorëzohet pranë AdZM-së, në territorin administrativ të së cilës ndodhet sipërfaqja që do të jepet në përdorim. Pavarësisht kërkesës nga subjekti, AdZM-të duhet të evidentojnë këto veprimtari dhe pas miratimit nga AKZM-ja marrin masat për lidhjen e kontratave në përputhje me këtë udhëzim.

6.10 Dokumentacioni që duhet paraqitur nga shoqëria që zotëron lejen/licencën përkatëse (sipas pikës 5.4, të këtij udhëzimi) përbëhet nga:

a) leja/licenca përkatëse nga institucioni qendror/vendor për ushtrimin e veprimtarisë;

b) kontrata/marrëveshja e lidhur me autoritetin përkatës për ushtrimin e aktivitetit;

c) projektin teknik dhe grafikun e punimeve të parashikuara;

d) hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes, objekt përdorimi, në formatin PDF dhe në format elektronik, në shkallën 1:10 000, ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: zona kadastrale sipas ASHK-së, ngastrat pyjore/kullosore, relievi, objektet aktuale, çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, si dhe

lidhjen me të dhënat për treguesit kadastral pyjor dhe kullosor;

e) lejen e mjedisit/deklaratën e ministrit përgjegjës për mjedisin;

f) lejen e ndërtimit për strukturat e përhershme;

g) aktin e regjistrimit pranë QKB-së;

h) planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme.

7. Rregullat për vlerësimin për dhënien në përdorim dhe gëzim të shërbimeve që ofron zona e mbrojtur (ZM) mjedisore

Drejtori i Përgjithshëm i AKZM-së miraton procedurën e shqyrtimit dhe të vlerësimit të kërkesave për përdorimin e shërbimeve që ofron ZM-ja, procedurë e cila kryhet nga strukturat e AdZM-ve.

Konkretisht:

7.1 Drejtori i AdZM-së përcakton, me urdhër, komisionin e ngarkuar për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesës. Para përcjelljes në AKZM, vlerësimi i komisionit konfirmohet nga përgjegjësi i sektorit të menaxhimit dhe miratohet nga drejtori i AdZM-së. Në vlerësimin e projektit dhe të kërkesës duhet të mbahen parasysh kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim dhe legjislacionin në fuqi.

7.2 Në rast se kërkesa nuk plotëson kushtet e përcaktuara përkatësisht në pikën 6.8 dhe 6.10, të këtij udhëzimi, brenda 10 ditëve pune AdZM-ja duhet të kthejë përgjigje për mosvazhdim procedure kërkuarit, duke i argumentuar arsyet e mosshqyrtimit të kërkesës.

7.3 Në rast se arsyeja e mosshqyrtimit të kërkesës lidhet me mungesa të dokumentacionit, referuar kërkesave të përcaktuara në pikën 6.8 dhe 6.10, të këtij udhëzimi, kërkuarit i lihet një afat prej 10 ditësh për plotësimin e dokumentacionit të munguar.

7.4 Në rast se kërkesa përmbush kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim, brenda 10 ditëve pune AdZM-ja duhet të dërgojë propozimin për miratim në AKZM, së bashku me dokumentacionin përkatës, i cili duhet të përmbajë:

a) sipërfaqen (territorin) e zonës së mbrojtur, të shprehur në metër katror (m^2), me kufij të përcaktuar qartë në harta të shkallës 1:10000 ose 1:25000 (koordinatat gjeografike, metrike);

b) përdorimin e tokës në sipërfaqen e zonës së mbrojtur të njehsuar (m^2), e cila cakton kategorinë e zonës së mbrojtur, zonimin e brendshëm të saj,



ekonominë pyjore/kullosore, numrin e parcelës, kufizimet natyrore dhe koordinatat, etj.;

c) treguesit identifikues (kadastral) të ngastrave ose nënngastrave;

d) karakteristikat biologjike e mjedisore të bimësisë në territor;

e) treguesit tekniko-ekonomik për kullotat dhe livadhet;

f) treguesit e vlerës për çdo njësi kadastrale të sipërfaqes (territorit) të zonës së mbrojtur që parashikohet të jepet me qira;

g) përllogaritjen e tarifës, e cila bëhet mbi bazën e raportit teknik, që do të jetë pjesë integrale e kontratës duke respektuar tarifat e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave;

h) sipërfaqja e propozuar të mos jetë objekt i ndryshimit të destinacionit në një afat 10-vjeçar (për investime publike ose projekte të një rëndësie të veçantë, do t'i referohemi legjislacionit përkatës).

7.5 Drejtoria përgjegjëse për menaxhimin në AKZM shqyrton/vlerëson kërkesën bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga AdZM-ja, sipas pikës 7.4 të këtij udhëzimi, brenda 20 ditëve pune.

7.6 Në rast se kërkesa e shqyrtuar/vlerësuar nuk plotëson kushtet e përcaktuara në këtë udhëzim, AKZM-ja duhet t'i kthejë përgjigje AdZM-së përkatëse duke i argumentuar arsyet e refuzimit të kërkesës.

7.7 Në rast se arsyeja e refuzimit të kërkesës lidhet me mungesa të dokumentacionit, referuar kërkesave të përcaktuara në pikën 7.4 të këtij udhëzimi, AdZM-ja, brenda 5 ditëve pune nga marrja e njoftimit, duhet të plotësojë mangësitë dhe të riparaqesë kërkesën për miratim.

7.8 Në rast se kërkesa plotëson kushtet e përcaktuara në pikën 7.4 të këtij udhëzimi, Ddrejtoria përgjegjëse për menaxhimin në AKZM propozon pranë Drejtorit të Përgjithshëm miratimin e kërkesës, e cila duhet të përmbajë:

a) objektin e veprimtarisë/shërbimit;

b) emrin e kërkuarit;

c) sipërfaqen (territorin) e zonës së mbrojtur, të shprehur në metër katror (m^2), me kufij të përcaktuar qartë në harta të shkallës 1:10 000 ose 1:25 000 (koordinatat gjeografike, metrike);

d) kategorinë e zonës së mbrojtur, zonimin e brendshëm të saj, ekonominë pyjore/kullosore, numrin e parcelës, kufizimet natyrore dhe koordinatat;

e) treguesit identifikues (kadastral) të ngastrave ose nënngastrave/numrin e pasurisë, zonën kadastrale;

f) afati i ushtrimit të aktivitetit/shërbimit.

7.9 Pas miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm, drejtoria përgjegjëse për menaxhimin përgatit aktin e miratimit të kërkesës dhe ia përcjell AdZM-së përkatëse për zbatim.

7.10 Administratat rajonale të zonave të mbrojtura (AdZM), pas aprovimit nga AKZM-ja të kërkesës, nënshkruajnë kontratën me subjektin kërkuar.

7.11 Ankesa për vendimarrjen bëhet pranë AKZM-së, brenda 5 ditëve pune nga marrja dijeni për vendimin objekt ankimi. Pranë AKZM-së ngrihet Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, i cili shprehet me vendim brenda 20 ditëve pune nga depozitimi i ankesës.

7.12 Pas nënshkrimit të kontratës nga AdZM-ja, sipërfaqja/objekti i dorëzohet palës tjetër me procesverbal dhe në përfundim të afatit të kontratës i merret përsëri në dorëzim nga AdZM-ja, po me procesverbal.

7.13 Kontrata, pavarësisht kohëzgjatjes së saj, konfirmohet çdo vit, automatikisht, ose pas një vendimi të AdZM-së përkatëse, pasi të jetë verifikuar zbatimi në praktikë i të drejtave dhe detyrimeve kontraktuale të palëve.

8. Procedura e mësipërme nuk zbatohet për dhënien në përdorim të sipërfaqeve kullosore. Dhënia në përdorim e këtyre sipërfaqeve bëhet pas miratimit nga Drejtori i AKZM-së, të parcelave që do të verifikohen në terren, për plotësimin e kushteve dhe kritereve të miratuara nga aktet ligjore për përdorimin e kullotave.

9. Deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1156, datë 24.12.2020, “Për përcaktimin e të ardhurave të gjeneruara nga tarifat që paguhet në zonat e mbrojtura, të masës dhe kritereve të përdorimit të tyre”, vlera e tarifave për shërbimet që ofron zona e mbrojtur mjedisore bazohet në VKM-në nr. 391, datë 21.6.2006, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar.

10. Urdhri nr. 129, datë 23.6.2016, i ministrit të Mjedisit “Për miratimin e procedurës së dhënies në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqeve në zonat e mbrojtura”, shfuqizohet.



11. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Blendi Klosi

UDHËZIM
Nr. 2, datë 2.2.2021

**PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN
E PROVIMEVE TË MATURËS
SHTETËRORE PROFESIONALE 2021**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 26 dhe 51, të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 7, germa “dh” dhe të nenit 8, germa “b”, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJMË:

1. Provimet e Maturës Shtetërore Profesionale 2021 për shkollat e mesme profesionale, të jenë:

Provime të detyruara: “Gjuhë shqipe dhe letërsi”, “Matematikë”, “Gjuhë e huaj” dhe “Teori profesionale e integruar”, sipas drejtimit/profilin që maturanti/kandidati ka ndjekur në shkollë.

2. Lëndët dhe datat për provimet e Maturës Shtetërore Profesionale 2021, të jenë:

- Gjuhë e huaj 3 qershor 2021;
- Gjuhë shqipe dhe letërsi 7 qershor 2021;
- Matematikë 11 qershor 2021;
- Teori profesionale e integruar 15 qershor 2021.

3. Administrimi i provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, bazohet në rregulloren e Maturës Shtetërore, të miratuar me urdhrin e përbashkët të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

4. Testi i gjuhës së huaj (D3) hartohet në përputhje me gjuhën e cila në planin mësimor të arsimit të mesëm profesional trajtohet si gjuhë e huaj e parë. Testi i provimit të jetë në nivelin gjuhësor që përcaktohet në kurrikul në përfundim të arsimit të mesëm profesional.

5. Gjuha e huaj, si provim i detyruar, përzgjidhet gjatë plotësimit të formularit A1/A1Z. Kandidatët e viteve të kaluara (të maturave shtetërore 2014, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020) që kanë rezultuar jokalue në provimin D3, duhet ta rijapin këtë provim. Kandidatët e tjerë, (të maturave shtetërore para vitit 2014) që aplikojnë me A1Z, nuk do ta rijapin provimin e detyruar D3.

6. Lista e provimit të detyruar të teorisë profesionale të integruar sipas drejtimit/profilin që maturantët/kandidatët kanë ndjekur në shkollat profesionale:

Nr.	Drejtimi/profili profesional
1	Hoteleri-turizëm
2	Shërbime mjetesesh transporti
3	Mekanikë
4	Elektroteknikë
5	Elektronikë
6	Përpunim druri
7	Ndërtim
8	Tekstil-konfeksione
9	Tekstil-konfeksione (NABER ADA)
10	Teknologji ushqimore
11	Bujqësi
12	Shërbime sociale dhe shëndetësore
13	Instalues i sistemeve termohidraulike
14	Teknologji kimike
15	Peshkim
16	Detari



17	Gjeologji-miniera
18	Llogari
19	Shërbime bankare
20	Sipërmarrje e agjencisë turistike
21	Sigurime
22	Tregti
23	Administrim biznesi
24	Rrjete të dhënash
25	Mbështetje e përdoruesve të TIK
26	Zhvillim <i>website</i>
27	Rrjete të dhënash (pilot-GIZ)
28	Inxhinieri informatike <i>softwaresh</i> (Hermann Gmeiner)
29	Silvikulturë
30	Agrobiznes
31	Veterinari
32	Gjeodezi
33	Biznes (Harry Fultz)
34	Elektronikë (Harry Fultz)
35	Automekanik (Harry Fultz)
36	Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji
37	Shërbime kujdesi për të moshuar (pilot GIZ)
38	Shërbime të udhëtimit dhe turizmit

7. Provimet e detyruara “Gjuhë shqipe dhe letërsi”, “Matematikë”, “Gjuhë e huaj e parë”, dhe programet orientuese të tyre, të mbështeten në programet ekzistuese të kulturës së përgjithshme të arsimit profesional.

8. Provimet e detyruara të Teorisë Profesionale të integruar, sipas tabelës në pikën 6, të mbështeten në programet orientuese të publikuara në faqen e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.

9. Kandidati i cili rezulton mbetës në të paktën njërin prej provimeve të detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale, duhet ta rijapë atë që të pajiset me diplomë.

10. Kandidati që në Maturën Shtetërore 2013–2016:

a) ka zgjedhur Teorinë Profesionale të Integruar dhe është kalues, të pajiset me diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, pavarësisht se mund të rezultojë jokalues në një apo dy provimet e tjera me zgjedhje;

b) ka zgjedhur Teorinë Profesionale të Integruar dhe rezulton mbetës, duhet të rijapë provimin e detyruar të Teorisë Profesionale të Integruar, pavarësisht rezultateve të provimeve të tjera me zgjedhje;

c) ka zgjedhur dy apo tri lëndë me zgjedhje, të cilat nuk përfshihet Teoria Profesionale e Integruar, duhet të japë provimin e detyruar të Teorisë Profesionale të Integruar, pavarësisht rezultateve të provimeve të tjera me zgjedhje.

11. Kandidatët që kanë marrë dëftesë pjekurie para vitit 2011 dhe dëshirojnë të aplikojnë për studime në institucionet e arsimit të lartë, t’u njihen provimet e detyruara ose provimet e njëvleftshme me to, të njësuara nga njësitë arsimore vendore. Këta kandidatë, në rastet kur nuk kanë dhënë provimin e Teorisë Profesionale të Integruar, ose e kanë dhënë dhe nuk kanë rezultuar kalues, kanë të drejtë të japin këtë provim, kur e kanë të nevojshme për plotësimin e kriterëve të pranimit të përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë.

12. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, zëvendësministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, zëvendësministri i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Sekretari i Përgjithshëm i MASR-së, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrat Arsimore



Vendore dhe Institucionet Arsimore, Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional në MFE, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, dhe Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE RINISË
Evis Kushi

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 81, datë 12.2.2021

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E POLONISË, SLOVAKISË,
HUNGARISË, GJERMANISË,
UKRAINËS, IZRAELIT, ÇEKISË,
RUMANISË, BULLGARISË, BELGJIKËS,
KROACISË, DANIMARKËS, FRANCËS,
HOLANDËS, LITUANISË DHE ITALISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, informacioni i marrë nga faqja zyrtare e Organizatës Ndërkombëtare të Mbrojtjes së Shëndetit të Kafshëve (OIE), si dhe bazuar në Kodin Shëndetësor të Kafshëve të Tokës dhe Ujit të OIE-së,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër;
 - b) zogjtë 24-orësh;
 - c) shpendë dekorativë;
 - d) materialit biologjik të shpendëve;
 - e) vezët e shpendëve;
 - dh) mishi i shpendëve;
 - e) nënproduktet e shpendëve.
- Nga shtetet e mëposhtme:

Nga shteti i Polonisë: përkatësisht provinca Wielkopolskie, rajoni Ostrowski, nënrajonin Przygodzice; përkatësisht provinca Zachodnio-Pomorskie, rajoni Mysłiborsk, nënrajonin Mysłiborz; përkatësisht provinca Wielkopolskie, rajoni Kolski, nënrajonin Dabie, rajoni wolsztyński, nënrajonin Siedlec; përkatësisht provinca Wielkopolskie, rajoni Ostrowski, nënrajonin Ostrow; përkatësisht provinca Dolnoslaskie, rajoni Legnicki, nënrajonin Chojnow; përkatësisht provinca Wielkopolskie, rajoni szamotulski, nënrajonin Ostrorog; përkatësisht provinca Wielkopolskie, rajoni Ostrowski, nënrajonin Raszkow; përkatësisht provinca Wielkopolskie, rajoni Wolsztyński, nënrajonin Wolsztyn; përkatësisht provinca Slaskie, rajoni Raciborski, nënrajonin Kuznia Raciborska; përkatësisht provinca Warminsko-Mazurskie, rajoni Llawski, nënrajonin Zalewo; përkatësisht provinca Warminsko-Mazurskie, rajoni Ostrodzki, nënrajonin Grunwald; përkatësisht provinca Opolskie, rajoni Kedzierzynsko-Kozielski, nënrajonin Kedzierzyn-Kozle; përkatësisht provinca Lodzkie, rajoni sieradzki, nënrajonin Blaszk; përkatësisht provinca Slaskie, rajoni Gliwicki, nënrajonin Wielowies; përkatësisht provinca Lodzkie, rajoni Lodzki Wschodni, nënrajonin Koluszki; përkatësisht provinca Lodzkie, rajoni Lowicki, nënrajonin Domaniewice; përkatësisht provinca Lodzkie, rajoni Poddebicki, nënrajonin Wartkowice; përkatësisht provinca Lodzkie, rajoni Zgierski, nënrajonin Aleksandrow Lodzki; përkatësisht provinca Wielkopolskie, rajoni Koninski, nënrajonin Grodziec; përkatësisht provinca Slaskie, rajoni Gliwicki, nënrajonin Wielowies; përkatësisht provinca Dolnoslaskie, rajoni Wroclawski, nënrajonin Dlugoleka; përkatësisht provinca Lubuskie, rajoni Sulecinski, nënrajonin Krzeszyce, rajoni Gorzowski, nënrajonin Lubiszyn; përkatësisht provinca Lubelskie, rajoni Lubartowski, nënrajonin Uscimow; përkatësisht provinca Lubelskie, rajoni Krasnostawski, nënrajonin Izbica dhe Zolkiewka; përkatësisht provinca Wielkopolskie, rajoni Wolsztyński, rrethi Wolsztyn dhe Siedlec, rajoni Grodziski, rrethi Rakoniewice dhe Wielichowo, rajoni Szamotulski, rrethi Pniewy, rajoni Klodzki, rrethi Klodzko; përkatësisht provinca Mazowieckie, rajoni Siedlecki, rrethi Suchozdebry, rajoni Gostyninski, rrethi Gostynin; përkatësisht provinca Warminsko-Mazurskie, rajoni Nowomiejski, rrethi Grodziczno, rajoni Piski, rrethi Pisz; përkatësisht



provinca Lubelskie, rajoni Leczynski, rrethi Ludwin, rajoni Radzynski, rrethi Wohyn; përkatësisht provinca Pomorskie, rajoni Slupski, rrethi Kobylnica, rajoni Wejherowsk, rrethi Kielno; përkatësisht provinca Zachodnio - Pomorskie, rajoni Koszalinski, rrethi Mielno; provinca Kujawsko-Pomorskie, rajoni siedlecki, rrethi Suchozobry, rajoni Gostyninski, rrethi Gostynin, rajoni Nowomiejski, rrethi Grodzicno, rajoni Piski, rrethi Pisz, rajoni leczynski, rrethi Ludwin, rajoni Radzynski rrethi Wohyn, rajoni Grudziadzki, rrethi Swiecie nad Osa, rajoni Olsztynski, rrethi Jeziorany, rajoni Inowroclawski, rrethi Gniewkowo dhe Inowroclaw, rajoni Chelminski, rrethi Lisewo.

Nga shteti i Sllovakisë: përkatësisht provinca Nitra, rrethi Nitra; fshati Zbehy, provinca Trnava, rrethi Trnava, fshati Cifer, rrethi Dunajská Streda, fshati Dobrohošť; provinca Trenčin, rrethi Prievidza, qyteti Bojnice; provinca Zilina, rrethi Cadca, fshati Stará Bystrica.

Nga shteti i Hungarisë: përkatësisht nga rajoni Bacs-Kiskun, fshati Csólyospálos, Szank, Kiskunfélegyháza, Kiskunmajsa, Kömpöc, Jászszentlászló, Nyárlőrinc, Mélykút, Bócsa, Soltvadkert, Bugac, Császártöltés, Kunfehértó, Orgovány, Kelebia, Jánoshalma, Kiskunhalas, Harkakötöny, Kiskunfélegyháza, Tázlár, Rem, Szank, Kisszállás, Petofiszállás; përkatësisht rajoni Komárom-Esztergom, fshati Ács, përkatësisht rajoni Csongrad, fshati Ruzsa, Forráskút, Zsombó, Pusztaszer, Csengele; përkatësisht rajoni Hajdu-Bihar, fshati Letavertes, rajoni Bekes, fshati Battonya, Nagykararás, Kondoros, Kisdombegyház, Battonya.

Nga shteti i Gjermanisë: përkatësisht provinca Baden-Württemberg, rrethi Hohenlohekreis, fshati Bretzfeld; provinca Niedersachsen, rrethi Aurich, fshati Dornum; provinca Sachsen-Anhalt, rrethi Börde, fshati Bülstringen; provinca Baden-Württemberg, rrethi Hohenlohekreis, Bashkia Bretzfeld; provinca Niedersachsen, rrethi Aurich, Bashkia Dornum; provinca Sachsen-Anhalt, rrethi Börde, Bashkia Bülstringen, provinca Schleswig-Holstein, rrethi Nordfriesland, Bashkia Langeneß, Emmelsbüll-Horsbüll, Pellworm, rrethi Segeberg, Bashkia Heidmühlen, rrethi Dithmarschen, Bashkia Neufelderkoog dhe Gudendorf; provinca Mecklenburg-Vorpommern, rrethi Vorpommern-Rügen, Bashkia Zingst; provinca Mecklenburg-

Vorpommern, rrethi Vorpommern-Rügen, Bashkia Rambin, rrethi Rostock, Bashkia Neubukow, rrethi Mecklenburgische Seenplatte, Bashkia Lärz, rrethi Nordwestmecklenburg, Bashkia Gadebusch, rrethi Vorpommern-Greifswald, Bashkia Wusterhusen, rrethi Ludwigslust - Parchim, Bashkia Dömitz; provinca Niedersachsen, rrethi Aurich, Bashkia Großheide, rrethi Cloppenburg, Bashkia Cloppenburg, Garrel, Bösel, rrethi Oldenburg, Bashkia Prinzhöfte, rrethi Cuxhaven, Bashkia Wurster Nordseeküste, rrethi Wittmund, Bashkia Wittmund; provinca Sachsen, rrethi Leipzig, Bashkia Grimma; provinca Brandenburg, rrethi Spree-Neiße, Bashkia Schenkendöbern, rrethi Prignitz, Bashkia Pirow; provinca Bayern, rrethi Bayreuth, Bashkia Pottenstein; provinca Thüringen, rrethi Nordhausen, Bashkia Bleicherode.

Nga shteti i Ukrainës: përkatësisht nga rajoni Vinnitsa, fshati Berezivka, Bratslav, Budky, Bugakiv, Chervone, Chukiv, Danylky, Dovzhok, Horodnytsia, Hrabovets, Hranitne, Karolina, Korovayna, Korzhiv, Korzhivka, Kryklivtsi, Maryanivka, Melnykivtsi, Monastyrok, Monastyrsk, qyteti Nemyriv, fshati Novi Obyhody, Ostapkiivtsi, Ozero, Perepelychcha, Rachky, Salyntsi, Samchyntsi, Sazhky, Selevyntsi, Sholudky, Slobidka, Sorokoduby, Sorokotiazhyntsi, Velyka Bushynka, Vovchok, Vyhanka, Yosypenko, Zarudyntsi dhe Zelenianka; përkatësisht nga qyteti Nikolayev, rrethi Nova Odesa, fshati Kandybyne dhe Novomatviivske, rrethi Ochakiv, fshati Yaselka, rrethi Mykolaiv fshati Trykhaty, rrethi Arbusynka, fshati Ivanivka, rrethi Domanivka, fshati Domanivka; përkatësisht nga qyteti Kiev, rrethi Ivankiv, fshati Leonivka, rrethi Borodianka, fshati Borodianka, rrethi Bucha, fshati Hostomel; përkatësisht nga qyteti Kherson, rrethi Kakhovka, fshati Zaozerne.

Nga shteti i Izraelit: përkatësisht provinca Hazafon, rrethi Yizreel, fshati Ma'ale Gilboa.

Nga shteti i Çekisë: përkatësisht provinca Vysocina, rrethi Zdar nad Sazavou, fshati Stepanov nad Svratkou; provinca Pardubický, rrethi Pardubice, fshati Slepotic; provinca Jihočeský, rrethi Tábor, fshati Dlouhá Lhota.

Nga shteti i Rumanisë: përkatësisht rajoni Maramures, provinca Seini.

Nga shteti i Bullgarisë: përkatësisht provinca Plovdiv, Kardzali, fshati Perperek dhe Trilistnik.



Nga shteti i Belgjikës: përkatësisht provinca West - Vlaanderen, Bashkia Menen.

Nga shteti i Kroacisë: përkatësisht qyteti Koprivnicko-Krizevacka, Bashkia Novigrad Podravski, fshati Delovi.

Nga shteti i Danimarkës: përkatësisht rajoni West, Bashkia Randers, fshati Tustrup, Bashkia Viborg, fshati Viborg.

Nga shteti i Francës: përkatësisht në ndarjen Yvelines, komuna Saint Cyr l'Ecole; ndarja Corse-Du-Sud, komuna Ajaccio; ndarja Haute-Corse, komuna Biguglia, Focicchia, Muro, Aregno, Bisinghi; e gjithë ndarja Landes; ndarja Vendée, komuna St Maurice des Noues, Saint-Christophe-du-Ligneron; ndarja Deux-Sèvres, komuna St Sauveur; ndarja Hautes-Pyrénées, komuna Labatut-Riviere, Estirac, Garderes; ndarja Pyrénées-Atlantiques, komuna Baigts-de-Bearn, Prechacq-Navarrenx, Lichos, Garlin, Uzan, Orthez, Louvie-Juzon, Saint- Giron-en-Bearn, Urdes, Lay-Lamidou, Garlin, Dognen, Sallespisse, Charre, Saint-Armou, Poey-D'Oloron, Nousty, Arget Puyoo, Ogenne-Camptort, Aren, Bidache, Saucedo, Montaner, Loncon, Castetpugon, Amorots - Succos, Momas, Arzacq Arraziguuet; ndarja Gers, komuna Montreal, Sainte-Christie-D'Armagnac, Barcelonne-du-Gers, Salles-D'Armagnac, Laujuzan, Manciet, Houga, Mauleon-D'Armagnac, Ayzieu, Barcelonne-du-Ger, Poey-D'Oloron, Castelnau D'Auzan Labarrer, Corneillan, Castex-D'Armagnac, Larroque-Sur-L'Osse, Lanne-Soubiran, Sorbets, Manciet, Monguilhem, Segos, Mauleon-D'Armagnac, Aurenza; ndarja Haute Garonne, komuna Grenade; ndarja Lot-Et-Garonne, komuna Sainte- Maure-de-Peyriac, Saint-pe-Saint-Simon.

Nga shteti i Holandës: përkatësisht provinca Gelderland, fshati Altforst, Puiflijk, Terwolde; provinca Groningen, fshati Lutjegast; provinca Friesland, fshati Witmarsum, Sint Annaparochie, Buitenpost; provinca Utrecht, fshati Hekendorp; provinca Zuid-Holland, fshati Maasland; provinca Noord-Brabant, fshati Moergestel.

Nga shteti i Lituanisë: përkatësisht rrethi Kaunas, qyteti Kunas.

Nga shteti i Italisë: përkatësisht provinca Emilia-Romagna, rrethi Ravenna, komuna Lugo.

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër, zogjtë 24-orësh, shpendë dekorativë, materialit biologjik, vezët e shpendëve, mishi i shpendëve dhe nënproduktet e shpendëve që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri i ministrit nr. 24, datë 14.1.2021 “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë, Sllovakisë, Hungarisë, Gjermanisë, Ukrainës, Izraelit, Çekisë, Rumanisë, Bullgarisë, Belgjikës, Kroacisë, Danimarkës, Francës, Holandës dhe Lituanisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Milva Ekonomi

VENDIM
Nr. 2, datë 8.2.2021

**PËR NJË SHITESË NË NORMAT
TEKNIKO-PROFESIONALE DHE
METODOLOGJIKE TË SHËRBIMIT
ARKIVOR NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 8, të vendimit nr. 360, të Këshillit të Ministrave, datë 21.4.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, të ndryshuar, me propozim të Kryetarit, Këshilli i Lartë i Arkivave

VENDOSI:

Në “Normat tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, të bëhet shtesa e mëposhtme:



1. Pas nenit 33/1 shtohet neni 33/2 me këtë përmbajtje:

“Institucioni qendror harton listën e dokumenteve tip, me afatet e ruajtjes së tyre, për institucionet e sistemit të varësisë. Kjo listë hartohet në mbështetje të Listës Tip, me afatet e ruajtjes së dokumenteve të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, dhe shërben si akt rregullator për hartimin e listave konkrete nga institucionet e tyre të varësisë.”.

2. Ngarkohen të gjitha autoritetet publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido

VENDIM
Nr. 3, datë 8.2.2021

**PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE TË
KUTIVE DHE DOSJEVE, PËR RUAJTJE
TË PËRHERSHME, SI DHE LISTËS SË
INSTITUCIONEVE DHE TIPOLOGJISË
E DOKUMENTEVE TË
INSTITUCIONEVE QË JANË TË
DETYRUARA TË ZBATOJNË KËTO
STANDARDE**

Mbështetur në pikën 1, të nenit 25, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për Arkivat”, dhe germës “ë” dhe “P”, të pikës 5, të nenit 8, të VKM-së nr. 360, datë 26.4.2017, “Për miratimin e rregullores ‘Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave’”, të ndryshuar, Këshilli i Lartë i Arkivave

VENDOSI:

1. Miratimin e standardeve të kutive dhe dosjeve, për ruajtje të përhershme, për arkivat jo në veprim dhe për institucionet që ruajnë dokumentacion gjithnjë pranë tyre, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Miratimin e listës së institucioneve dhe tipologjinë e dokumenteve të institucioneve që janë të detyruara të zbatojnë standardin e kutive dhe dosjeve për arkiva të përhershme, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Autoritetet publike mund të përdorin kuti dhe dosje me përmasa të ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë vendim, vetëm nëse kanë marrë paraprakisht miratimin me shkrim nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe institucionet e përmendura në këtë vendim për zbatimin e tij.

5. Vendimi nr. 5, datë 26.6.2019, “Për miratimin e standardeve të kutive dhe dosjeve për ruajtje të përhershme, si dhe listës së institucioneve dhe tipologjisë e dokumenteve të institucioneve që janë të detyruara të zbatojnë këto standarde” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido





Shtojca 1


**STANDARTET E KUTIVE DHE DOSJEVE PËR RUAJTJE TË PËRHERSHME
PËR ARKIVAT JO NË VEPRIM DHE PËR INSTITUCIONET QË RUAJNË
DOKUMENTACION GJITHNJË PRANË TYRE**


Lloji	Përmasat	Specifikimet teknike
Kuti për ruajtje të përhershme	40x28x18	<u>Kutia:</u> - Ndërtuar nga karton i fortë e i valëzueshëm, me gramatur 620 gr/m² që të lejojë valzueshmërinë. - Faqet anësore me fortësi të dyfishtë, faqet fundore me trashësi të dyfishtë. - Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5. - Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. - Të përmbajnë jo më shumë se 1% lignin - Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar). - Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura. <u>Dosja:</u> - Kartoni të jetë 330 gr/m², me 2 krahë, krahët të brenda shkruar të palosura 20 cm, pjesa frontale me kthim pa ngjitje. - Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5. - Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. - Të përmbajnë jo më shumë se 1% lignin - Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar). - Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura.
Kuti për ruajtje të përhershme për amza	40x55x18	
Kuti për ruajtje të përhershme për regjistra	40x70x9	
Dosje për ruajtje të përhershme	37x26	

Bashkëngjitur dhe skicatë e kutive dhe dosjeve me ruajtje të përhershme.



Kutia model 1" Dimensione perfundimtare 40x28x18 cm


**Kutia model 2: Dimensioe perfundimtare 40x55x18 cm**



Kuti model 3 me permasa perfudimtare 40x70x9 cm



Dosje me permasa te brendshme 360x240 mm





Shtojca 2

**LISTA E INSTITUCIONEVE DHE TIPOLOGJIA E DOKUMENTEVE TË
INSTITUCIONEVE, QË JANË TË DETYRUARA TË ZBATOJNË STANDARDIN
E KUTIVE DHE DOSJEVE PËR ARKIVA TË PËRHERSHME**

1. Arkivat shtetëror të sistemimit, tipologjisë dhe institucionet e pavarura Kushtetuese, që sipas ligjit i ruajnë dokumente përherë pranë tyre.
2. Institucionet qendrore e të varësisë, si më poshtë:
 - a. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (*Regjistra të gjendjes civile; Regjistra të lindjes dhe vdekjes; Regjistra për martesat dhe zgjidhje të martesave etj.*)
 - b. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë (*Kartoteka*)
 - a. Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (*Dosjet me dokumentacion tërësor, për patentat, licencat, mbrojtjen e të drejtës së autorit që ruhen mbi 50 vjet*)
 - b. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor (*Regjistra të lejeve të drejtimit, qarkullimit dhe mjeteve të transportit*)
 - c. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (*Regjistra të subjekteve tatim-pagues që ruhen mbi 50 vjet*)
 - d. Instituti i Sigurimeve Shoqërore (*Librat e pagave, Bordero, etj.*)
 - e. Agjencia Shtetërore e Kadastrës (*Dokumente për regjistrimin, shqyrtimin dhe verifikimin e pasurive të paluajtshme që ruhen mbi 50 vjet, regjistra, etj.*)
 - f. Spitalet Universitare dhe Rajonale (*Kartelat shëndetësore që ruhen mbi 50 vjet*)
 - g. Institucionet e Arsimit të Lartë dhe Parauniversitar (*Regjistrat e amzave, librat e indekseve, etj.*)
3. Institucione të tjera që ruajnë e administrojnë dokumente tipologjike mbi 50 vite, i kërkojnë Këshillit të Lartë të Arkivave, përfshirjen në këtë vendim.



URDHËR
Nr. 136, datë 12.1.2021

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 11/b, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, z. Endrit Musaj, drejtor i Inspektimit dhe Trajnimeve, për shkak të mungesës me arsye të titullarit të këtij institucioni.

2. Kompetencat e drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave do të ushtrohen për periudhën nga data 15.2.2021 deri në datën 19.2.2021.

3. Nuk delegohen kompetencat e drejtuesit lidhur me personelin, si dhe kompetencat e tjera të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Për veprimet e kryera në zbatim të këtij urdhri, drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve do të ruajë kopje të kartelave shoqëruese të praktikave shkresore, të iniciuara apo të përfunduara prej tij, së bashku me afatet e përcaktuara dhe ecurinë e mbarëvajtjes e çështjeve, dhe do t’ia bëjë të ditura titullarit me rikthimin e tij në detyrë.

5. Për zbatimin e urdhrit ngarkohet drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve, z. Endrit Musaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido

VENDIM
Nr. 3, datë 11.2.2021

PËR ANËTARËSIMIN E SHOQËRISË SË
KURSIM-KREDITIT “FAST CREDIT
ALBANIA” NË SKEMËN E SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE DHE DHËNIEN E
CERTIFIKATËS PËR SIGURIMIN
E DEPOZITAVE

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 22, pika 5 dhe pika 6, të nenit 23 dhe të nenit 52, pika 1, shkronja “p”, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar; të nenit 69, pika 2, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”; të nenit 7, pika 2 dhe pika 3, të udhëzimit nr. 4188, datë 1.9.2016, “Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit”; të nenit 10, pika 6, dhe të nenit 18, pika 2, të rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, si dhe të njoftimit të Bankës së Shqipërisë mbi dhënien e licencës shoqërisë së kursim-kreditit “Fast Credit Albania” me anë të shkresës nr. 112 prot., datë 9.2.2021, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

VENDOSI:

1. Anëtarësimin e shoqërisë së kursim-kreditit “Fast Credit Albania” në skemën e sigurimit të depozitave, si dhe dhënien e certifikatës për sigurimin e depozitave, sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm për njoftimin e shoqërisë së kursim-kreditit “Fast Credit Albania” për anëtarësimin në skemën e sigurimit të depozitave dhe për dorëzimin e certifikatës për sigurimin e depozitave, si dhe të informojë Autoritetin Mbikëqyrës mbi këtë vendim.

3. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare, shpallet në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë, si dhe në një gazetë kombëtare.

4. Ngarkohen Sektori i Sigurimit dhe Kompensimit të Depozitave, Sektori i Marrëdhënieve me Publikun, dhe Sektori i



Administratës dhe Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Donald Duraj

VENDIM
Nr. 3, datë 15.1.2021

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË OST
SHA PËR SHTYRJEN E AFATIT TË
MARRJES NË SHQYRTIM TË
KËRKESËS, PËR RISHIKIMIN E
VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR.
169, DATË 3.11.2020, “PËR SHQYRTIMIN
E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR
VITIN 2020 DHE ATË TË
PËRDITËSUAR, DHJETËVJEÇAR, 2015–
2025, TË ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË
TRANSMETIMIT TË SHOQËRISË
OST SH.A.”**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, gerrat: “a” dhe “e”, nenit 60, pikat 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 43/, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 53, pika 3 dhe të neneve 91 dhe 92, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të neneve 6, 7, 8, 10, 11 dhe 12, të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr.135, datë 6.9.2017, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.1.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 7/2 prot., datë 13.1.2021, të Drejtorive Teknike, mbi kërkesën e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) për zgjatjen e afatit për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 169, datë 3.11.2020, “Për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020 dhe atë të përditësuar, dhjetëvjeçar, 2015–2025, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a.”

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 216, datë 15.12.2020, vendosi shtyrjen e afatit të shqyrtimit të

Faqe | 3566

kërkesës së paraqitur nga shoqëria OST sh.a. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 169, datë 3.11.2020, “Për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020 dhe atë të përditësuar, dhjetëvjeçar, 2015–2025, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a.”, deri në 30 ditë.

- OST sh.a., me shkresën drejtuar në ERE nr. 165 prot., datë 11.1.2020, parashtroi se:

Përmes shkresës me nr. 6967/2 prot., datë 21.12.2020, është vënë në dispozicion informacioni shtesë i kërkuar për rishikimin e vendimit nr. 169, datë 3.11.2020, përkatësisht “Draftmetodologjia e vlerësimit kosto – përfitim të projekteve të rrjetit shqiptar të transmetimit”, ku theksohet që ky material është hartuar nga grupi i punës, i ngritur për këtë qëllim, dhe mbetet i tillë, në pritje të finalizimit pasi të jenë reflektuar dhe elementë të tjerë që mund të dalin nga studimi i masterplanit të zhvillimit të rrjetit të transmetimit.

- Procesi i hartimit të masterplanit të OST sh.a., “Plani mbi investimet dhe zhvillimin e rrjetit për sektorin e transmetimit të energjisë në Shqipëri për vitet 2018–2033” ka hyrë në fazën përfundimtare dhe sipas skedulit të fundit të miratuar pritet që drafti final i masterplanit të disponohet në fund të dhjetorit.

- Gjatë vitit 2020, afati i përfundimit të masterplanit është shtyrë dy herë për shkak të kufizimeve të krijuara për shkak të pandemisë COVID-19.

- Në respekt të përcaktimeve ligjore, masterplani do të hyjë në fuqi pasi ai të miratohet edhe nga ERE. Për këtë arsye, nëse gjithçka shkon sipas parashikimeve të afateve, OST-ja do të dërgojë për miratim në ERE draftin final të masterplanit për miratim brenda muajit janar.

- Një nga risitë e masterplanit është edhe metodologjia e zhvillimit të tij, e cila është zbatuar në studim. Ky trajtim merr në konsideratë të gjithë paketën e investimeve ekzistuese, si dhe zgjerimin, të cilit i përkasin projektet e reja që dalin si rezultat i analizës së rrjetit në projeksion për të ardhmen.

- Duke qenë se momentalisht jemi në një fazë shumë të ngjeshur, në të cilin kërkohet një integrim dhe përqendrim i burimeve, përshtatje e metodologjive dhe respektim të afateve të paracaktuara, për të gjitha zhvillimet aktuale dhe në të ardhmen të rrjetit të transmetimit, parashtrohet kërkesa për shtyrje.



- Për të analizuar të gjitha elementet e nevojshme, në mënyrë që të jepet një gjykim dhe argumentim i drejtë, i saktë dhe shterues i kërkesës së parashtruar nga OST sh.a., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 169, datë 3.11.2020, OST sh.a. duhet të paraqesë të gjithë informacionin e kërkuar nga ERE nëpërmjet komunikimeve zyrtare, me qëllim ezaurimin e procedurës administrative dhe marrjen e një vendimi mbi këtë çështje, si dhe është përcaktuar përkatësisht në nenet 53, pika 3 dhe nenet 91 dhe 92, të “Kodit të Procedurave Administrative”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatit të marrjes në shqyrtim të kërkesës për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 169, datë 3.11.2020, “Për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020 dhe atë të përditësuar, dhjetëvjeçar, 2015–2025, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a.”, deri në 30 ditë.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palën e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 4, datë 15.1.2021

MBI KËRKESËN E FSHU SHA PËR DISA NDRYSHIME NË “KONTRATËN TIP PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE, NDËRMJET SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE/KESH SHA, AKSIONET E SË CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI DHE FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL/FSHU SHA, PËR FURNIZIMIN E KLIENTËVE FUNDORË”

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 20, germa “h”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të vendimit nr. 244, datë

30.3.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar; “Rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin nr. 214, datë 28.12.2017, të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) dhe neneve 15 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.1.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 7/3 prot., datë 13.1.2021, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike,

konstatoi se:

- Në kuptim të vendimit nr. 244, datë 30.3.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar, ERE ngarkohet me detyrën për miratimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike, ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal/FSHU sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 170, datë 4.11.2020, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së FSHU sh.a. dhe KESH sh.a., për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 73/2020, “Mbi miratimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike, ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/FSHU sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë”.

- Në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 170/2020, nëpërmjet shkresës nr. 1204 prot., datë 12.11.2020, me lëndë “Lidhur me fillimin e procedurave mbi kërkesën e FSHU sh.a., për disa ndryshime në kontratën tip për shitblerjen e energjisë elektrike, ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike/KESH sh.a., aksionet e të cilës kontrollohen plotësisht ose



pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal /FSHU sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë”, është përcjell drafti i kontratës për të shprehur opinionet përkatëse institucioneve: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a., Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a., Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a., Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), *Foring Investors Association of Albania* (FLAA), *Albania Renewable Energy Association* (AREA), Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

- Afati i përcaktuar në shkresën nr. 1204 prot., datë 12.11.2020, për dhënien e opinionit/komenteve nga institucionet e sipërpërmendura është 20 ditë nga marrja dijeni nëpërmjet kësaj shkrese.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, nëpërmjet shkresës nr. 8014/1 prot., datë 16.12.2020, ka parashtruar si më poshtë:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, pasi u njoh me përmbajtjen e vendimit të Bordit të ERE-s me nr. 170, datë 4.11.2020, dhe “Draftkontratën tip për shitblerjen e energjisë elektrike, ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike/KESH sh.a., aksionet e të cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal /FSHU sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë”, shprehet dakord për vijimin e procedurës nga ana juaj, në zbatim të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

- Me shkresën nr. 1115 prot., datë 24.9.2020, shoqëritë KESH sh.a. dhe FSHU sh.a., së bashku i janë drejtuar ERE me kërkesën për miratimin e kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike nënshkruar midis shoqërive KESH sh.a. dhe FSHU sh.a., për periudhën kohore 1 janar – 31 dhjetor për vitet 2020 dhe 2021. Drafti i kontratës së propozuar për t’u miratuar nga ERE, për vitin 2021, është negociuar dhe dakordësuar nga palët KESH sh.a. dhe FSHU sh.a.

- Dispozitat që ndryshojnë në kontratën e propozuar për miratim nga shoqëritë KESH sh.a. dhe FSHU sh.a., me nr. 8325 prot., datë 23.9.2020, të FSHU sh.a., dhe nr. 2920/1 prot., datë

24.9.2020, të KESH sh.a., kryesisht janë si më poshtë:

- Neni 1, ndryshon: shtohet shprehja: (...së bashku me shtojcat apo anekset e saj...);

- Neni 2, ndryshon: është hequr shprehja: (ose kompensojë financiarisht);

- Në pikën 3, ndryshon shprehja në: (...me çmimin e HUPLEX për atë moment...);

- Në pikën 4, ndryshon shprehja në: (...brenda afatit të vendosur nga shitësi...).

- Neni 3, ndryshon, shtohet një term në pjesën Përkufizimet: “Pamundësia e prodhimit si rrjedhojë e kushteve hidrike për efekt kompensimi, përcaktohet nga niveli minimal në liqenin e Fierzës në fund të çdo muaji (shtojca 3), nën të cilin shitësi, me kërkesën e blerësit, është i detyruar të prodhojë, duke mos qenë subjekt i kompensimit financiar sipas pikës 1, të nenit 9, të kësaj kontrate;

Neni 5 - Është shtuar pika e pestë me përmbajtje (5. Shitësi ka detyrimin që në fund të çdo muaji të njoftojë blerësin, në lidhje me nivelin në liqenin e Fierzës, me qëllim evidentimin e faktit nëse ndodhet në kushtet e pamundësisë së prodhimit, si rrjedhojë e kushteve hidrike, për efekt kompensimi sipas përcaktimeve të kësaj kontrate);

- Neni 9, në pikën 4 ndryshon në (...paguhen sipas nenit 13);

- Pasi u kryen verifikimet përkatëse, rezulton se në kontratën e dakordësuar:

- Neni 3, pika 21 shprehet: “Pamundësia e prodhimit si rrjedhojë e kushteve hidrike për efekt kompensimi”, përcaktohet nga niveli minimal në liqenin e Fierzës në fund të çdo muaji (shtojca 3), nën të cilin shitësi, me kërkesën e blerësit, është i detyruar të prodhojë, duke mos qenë subjekt i kompensimit financiar sipas pikës 1, të nenit 9, të kësaj kontrate. ERE vlerëson që ky paragraf, për qëllime të përcaktimit të nivelit minimal të liqenit të Fierzës, nga palët, të bazohet në rregullat për menaxhimin e kaskadës në lumin Drin, si dhe në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë atë. Si të tillë, neni 3, pika 21, duhet të përfshijë edhe togfjalëshin (shtojca 3, përfshirë, por jo duke u kufizuar, dhe aktet nënligjore në fuqi), konkretisht: “Pamundësia e prodhimit si rrjedhojë e kushteve hidrike për efekt kompensimi” përcaktohet nga niveli minimal në liqenin e Fierzës në fund të çdo muaji (shtojca 3, bazuar në rregullat për menaxhimin e kaskadës në lumin Drin, përfshirë por jo duke u kufizuar dhe në aktet nënligjore në



fuqi) nën të cilin shitësi, me kërkesën e blerësit, është i detyruar të prodhojë, duke mos qenë subjekt i kompensimit financiar sipas pikës 1, të nenit 9, të kësaj kontrate;

- Në ndryshimet e propozuara nga palët, në nenin 11, është kërkuar të përcaktohet në kontratë se: “Kontrata është e vlefshme për periudhën 1 janar – 31 dhjetor, të vitit 2020 dhe 2021.”.

- Ky nen duhet të mbetet i pandryshuar, si dhe përcaktuar në kontratën tip, konkretisht: “Kontrata është e vlefshme për periudhën 1 janar – 31 dhjetor (të çdo viti).”.

- Neni 20, pika 1, shprehet se: “Kjo kontratë i shtrin efektet për periudhën 1 janar – 31 dhjetor, për vitet 2020 dhe 2021.”.

- Ky nen duhet të mbetet i pandryshuar, sipas kontratës Tip, konkretisht: “Kjo kontratë i shtrin efektet për periudhën 1 janar – 31 dhjetor (të çdo viti).”.

Palët kanë adresuar në kontratë edhe rregullimin lidhur me shitjen e tepricave të energjisë elektrike mbi sasinë e përcaktuar në kontratë. Palët parashikojnë që, në çdo rast energjia e ofruar mbi sasinë e përcaktuar në kontratë do të përdoret vetëm për nevojat të furnizimit të shërbimit universal, bazuar në çmimin e referuar në bursën hungareze.

- Vërehet së VKM-ja nr. 244/2016, e ndryshuar, parashikon pikërisht që energjia elektrike, pas plotësimit të nevojave të furnizimit universal, të ofrohet për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes me çmimin mesatar të HUPEX. Vlerësohet të përdoret i njëjti referim lidhur me energjinë e tepërt pas mbulimit të sasisë së përcaktuar në kontratë nga shoqëria publike e prodhimit.

- Palët janë të njohura paraprakisht me kontratën, pasi kontrata është negociuar dhe dakordësuar ndërmjet tyre. Në të njëjtën kohë dhe mekanizmat e përcaktuar në këtë kontratë, në mënyrë që të realizonin respektivisht KESH sh.a., planifikimin/prodhimin e energjisë elektrike përgjatë vitit, dhe FSHU sh.a., planifikimin e kërkesës për energji elektrike për klientët fundor.

Palët në kontratë, çdo vit ushtrimor, reflektojnë në kontratë, përveç periudhës kalendarike që mbulon çdo kontratë, të gjitha të dhënat që në kuptim të parashikimeve të legjislacionit në fuqi përditësohen, ku përfshihen ndryshimet që mund të ndodhin në legjislacionin primar dhe sekondar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve të kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike, ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal/FSHU sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73/2020, si më poshtë:

A. Neni 1, ndryshon: shtohet shprehja (...së bashku me shtojcat apo anekset e saj...);

B. Neni 2, pika 1, ndryshon: hiqet shprehja (ose kompensojë financiarisht);

C. Në nenin 2, në pikën 3, ndryshon shprehja në: (...me çmimin mesatar të HUPEX).

- Neni 3, shtohet termi: “Pamundësia e prodhimit si rrjedhojë e kushteve hidrike për efekt kompensimi” përcaktohet nga niveli minimal në liqenin e Fierzës në fund të çdo muaji (shtojca 3), bazuar në rregullat për menaxhimin e kaskadës në lumin Drin, përfshirë dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi) nën të cilin shitësi, me kërkesën e blerësit, është i detyruar të prodhojë, duke mos qenë subjekt i kompensimit financiar sipas pikës 1, të nenit 9, të kësaj kontrate.

- Në nenin 5, shtohet pika pesë me përmbajtje (5. Shitësi ka detyrimin që në fund të çdo muaji të njoftojë blerësin, në lidhje me nivelin në liqenin e Fierzës, me qëllim evidentimin e faktit nëse ndodhet në kushtet e pamundësisë së prodhimit, si rrjedhojë e kushteve hidrike, për efekt kompensimi sipas përcaktimeve të kësaj kontrate);

D. Neni 9, behën ndryshimet si vijon:

1. Rasti i mosperformancës nga ana e shitësit: Blerësi (“Pala pranuese”) ka të drejtën e një kompensimi për sasinë e energjisë elektrike që rezulton si diferencë ndërmjet sasisë vjetore të përcaktuar në pikën 1, të nenit 2 dhe asaj të nominuar në sistemin DAMAS, sipas parashikimeve të neneve 4 dhe 5.

Kompensimi do të jetë vjetor dhe do të përllogaritet në bazë të të dhënave mujore, në atë shkallë që shitësi (“Pala livruese”) nuk i konfirmon blerësit të gjithë sasinë mujore/javore/ditore të përcaktuar në pikën 1, të nenit 2 të kontratës (shtojca nr. 1), por në çdo rast jo më shumë se sasia e nevojshme për furnizimin e klientëve fundorë që



përfitojnë nga shërbimi universal i furnizimit dhe kjo paaftësi nuk shfajësohet nga një ngjarje e forcës madhore apo nga pamundësia e shitësit për të prodhuar, si rrjedhojë e kushteve hidrike për efekt kompensimi.

Çmimi mbi të cilin do të llogaritet kompensimi do të jetë çmimi HUPX, në muajin kur përllogaritet kompensimi minus çmimin e përcaktuar në nenin 2, pika 2, të kësaj kontrate.

2. Rasti i mosrespektimit nga ana e blerësit: 2- Në atë shkallë që programet e nominuara në sistemin DAMAS, nga blerësi dhe nga shitësi, për ditën në avancë (ose *intraday*), sipas parashikimeve të neneve 4 dhe 5, rezultojnë më të vogla se sasia e konfirmuar për muajin në avancë, kjo sasi energjie do të trajtohet si e depozituar te shitësi dhe duhet të përdoret nga blerësi brenda muajit pasardhës.

3. Në atë shkallë që programet e nominuara në sistemin DAMAS nga blerësi dhe nga shitësi për ditën në avancë (ose *intraday*), sipas parashikimeve të neneve 4 dhe 5, rezultojnë më të mëdha se sasia e parashikuar në pikën 1, të nenit 2, dhe kjo energji ka shkuar për furnizimin e klientëve fundorë, atëherë shitësi konsiderohet se ka përmbushur detyrimin kontraktual në përputhje me pikën 1, neni 2, të kontratës.

E. Neni 11 bëhet: Kontrata është e vlefshme për periudhën 1 janar – 31 dhjetor të çdo viti.

2. Këto ndryshime të reflektohen nga palët në kontratën për shitblerjen e energjisë elektrike, ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal/FSHU sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë, për vitin 2021 e në vijim.

3. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 5, datë 15.1.2021

MBI ANULIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 226, DATË 15.12.2020, “MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 209, SERIA T13, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË ‘SHUTINA ENERGJI’ SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 109, DATË 1.10.2013

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, pikës 2, të nenit 117, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 16, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.1.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 143/2 prot., datë 30.12.2020, të përgatitur nga Grupi i punës, Mbi anulimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 226, datë 15.12.2020, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 209, seria T13, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Shutina Energji’ sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 1.10.2013,

konstatoi se:

- Me shkresën e ERE-s nr. 1172/1 prot., datë 4.11.2020, shoqëria “Shutina Energji” sh.p.k. është njoftuar për nisjen e hetimit administrativ për marrjen e masave ligjore, për pagesat e rregullimit të pashlyera ndaj ERE-s nga ana e saj, duke i kërkuar që brenda 5 ditëve nga marrja e këtij njoftimi të japë shpjegimet përkatëse në lidhje me statusin e shlyerjes së kësaj debie.

- Në përfundim të afateve të përcaktuara në këtë njoftim, rezultoi se subjekti “Shutina Energji” sh.p.k. nuk kishte përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkuar.

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 226, datë 15.12.2020, ka vendosur të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 209, seria T13, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Shutina Energji” sh.p.k. me



vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 1.10.2013, për shkak se shoqëria nuk ka shlyer në afat pagesën e rregullimit për vitin 2019.

- Shoqëria u njoftua për vendimin e Bordit të ERE-s nr. 226, datë 15.12.2020, me shkresën nr. 1172/1-3 prot., datë 23.12.2020.

- Me *email*-in e datës 29.12.2020, në adresën e postës elektronike të ERE-s, shoqëria “Shutina Energji” sh.p.k. ka deklaruar se e ka shlyer pagesën e rregullimit ndaj ERE-s dhe se për këtë ka depozituar në ERE dokumentacionin përkatës vërtetues.

- Pas rakordimit ka rezultuar se është bërë një gabim material në *database*-n e të dhënave në lidhje me debitorët ndaj ERE-s, për pagesat e rregullimit korrente dhe ato të prapambetura, dhe shoqëria “Shutina Energji” sh.p.k., si rrjedhojë e këtij gabimi material, rezultonte debitorë për pagesat e rregullimit të prapambetura të vitit 2019.

- Me konstatimin e sa më sipër, rezulton se shkak ligjor për të cilin ERE vendosi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 209, seria T13, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Shutina Energji” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 1.10.2013, nuk ekziston dhe për rrjedhojë vendimi i Bordit të ERE-s nr. 226, datë 15.12.2020, është marrë në kushtet e një gabimi material në të dhënat që shërbyen si shkak ligjor për marrjen e tij.

- Në nenin 113, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” parashikohet si vijon:

“1. Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj.

2. Anulimi ose shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë.”.

- Në pikën 2, të nenit 117, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” parashikohet si vijon:

“- Në çdo rast tjetër, të ndryshëm nga ai i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, anulimi ose shfuqizimi mund të bëhet brenda 30 ditëve nga dita kur organi publik është njohur me faktet që çojnë në anulimin ose shfuqizimin, por jo me vonë se 5 vjet nga njoftimi i aktit administrativ.”.

- Me anulimin e vendimit të ERE-s nr. 226, datë 15.12.2020, ndryshon statusi i të licencuarit “Shutina Energji” sh.p.k. në raport me ERE-n, nga debitor në jodebitor.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Anulimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 226, datë 15.12.2020, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 209, seria T13, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Shutina Energji’ sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 1.10.2013”.

2. Grupi i Punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 6, datë 15.1.2021

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË ALBGAZ PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË PËRCAKTUARA NË RREGULLOREN E KRITEREVE STANDARDE DHE KËRKESAVE MINIMALE TË CILËSISË SË SHËRBIMIT DHE FURNIZIMIT TË RRJETEVE TË GAZIT NATYROR, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 100/2019

Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 16, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të nenit 113, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”, si dhe të nenit 26, të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të



Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.1.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve, me nr.143/3 prot., datë 30.12.2020, në lidhje me kërkesën e shoqërisë Albgaz sh.a. për shtyrjen e afateve të përcaktuara në rregulloren e kriterëve standarde dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 100/2019,

konstatoi se:

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 100, datë 21.6.2019, është miratuar “Rregullorja për përcaktimin e standardeve dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit në sektorin e gazit natyror”.

- Në nenin 5.2, të kësaj rregulloreje është parashikuar që: “brenda një viti nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, por jo më vonë se muaj janar 2021, OSSh-G, OST-G dhe çdo i licencuar tjetër përkatës, do të ndërtojnë mjetet e përshtatshme duke përfshirë edhe mbi bazë IT (teknologji informacioni), të aftë për të regjistruar dhe për të mundësuar aksesin në të dhënat aktuale dhe ato historike të QPI-së.”.

- Nisur nga parashikimet e sa më sipër, ERE, me anë të shkresës nr.1237 prot., datë 16.12.2020, iu drejtua shoqërisë Albgaz sh.a. me kërkesën për informacion në lidhje me masat e marra nga ana e kësaj shoqërie për plotësimin e kushteve të parashikuara në dispozitën e sipërcituar të “Rregullores për përcaktimin e standardeve dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit në sektorin e gazit natyror”.

- Në përgjigje të kërkesës së ERE-s për informacion, në datë 28.12.2020, është paraqitur në ERE përgjigja e shoqërisë ALBGZ sh.a. me nr. 211 prot., e cila mes të tjerave kërkon nga ERE shtyrjen e afateve të plotësimit të kushtit që rrjedh si detyrim i nenit 5.2, të kësaj rregulloreje deri në 21.6.2021.

- Albgaz sh.a. argumenton këtë kërkesë duke shpjeguar se, duke marrë shkas nga kompleksiteti dhe diversiteti i objektit të kësaj rregullore, sugjeron që në vitin e ardhshëm 2021, nën drejtimin e ERE-s, të krijohen kushte për zhvillimin e konsultimeve me palët subjekt të rregullores (vendim nr. 100/2019), duke synuar kështu krijimin e një platforme teknologjike të përshtatshme, që

kontribuon në zbatimin e përpiktë të standardeve të furnizimit dhe të ofrimit të shërbimit.

- Albgaz sh.a. bën me dije se, për arsye të pezullimit apo shtyrjes së projekteve të infrastrukturës së gazit, shtyrja e investimeve për ndërtimin apo rehabilitimin e infrastrukturës së nevojshme i dedikohet në masë të madhe efektit të pandemisë *COVID-19*, i cili është përtej vullnetit të mirë të shoqërisë Albgaz sh.a. në drejtim të implementimit të detyrimeve që burojnë nga kjo rregullore.

- Kërkesa e shoqërisë Albgaz sh.a., për shtyrje të afateve të parashikuara në vendimin e Bordit të ERE-s nr.100/2019, me të cilin është miratuar “Rregullorja për përcaktimin e standardeve dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit në sektorin e gazit natyror”, është përcjellë në ERE përpara përfundimit të afateve të parashikuara në nenin 5.2 të këtij akti.

- Në kuptimin formal të kësaj kërkesë, rezulton se ajo është përcjellë brenda afateve ligjore të përcaktuara në vendimin e Bordit të ERE-s.

- Sa i përket palës që paraqet këtë kërkesë, vlerësojmë se ajo legjitimohet në kuptim të parashikimeve të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 100/2019, për të paraqitur në ERE një kërkesë për shtyrje të afateve të parashikuara në “Rregulloren për përcaktimin e standardeve dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit në sektorin e gazit natyror”, në cilësinë e palës së përfshirë në procedurë.

- Shpjegimet e dhëna nga shoqëria Albgaz sh.a., në lidhje me pamundësinë objektive për të përmbushur kushtet e vendosura në nenin 5.2, të “Rregullores për përcaktimin e standardeve dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit në sektorin e gazit natyror”, janë të arsyeshme.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë Albgaz sh.a. për ndryshimin e afateve të parashikuara në nenin 5, pika 2, të “Rregullores për përcaktimin e standardeve dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit në sektorin e gazit natyror”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 100/2019, si më poshtë:



Jo më vonë se 21.6.2021, OSSh-G, OST-G dhe çdo i licencuar tjetër përkatës do të ndërtojnë mjetet e përshtatshme, duke përfshirë edhe mbi bazë IT (teknologji informacioni), të aftë për të regjistruar dhe për të mundësuar aksesin në të dhënat aktuale dhe ato historike të QPI-së.

2. Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi në 1.1.2021.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 8, datë 20.1.2021

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 443, SERIA P19, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË “SANG 1” SHPK ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 83, DATË 31.5.2019, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 5, germa “a”, të nenit 6 dhe nenit 7, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; të pikës 6.1, germa “a” dhe pikës 6.2, të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016, si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.1.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 9/8 prot., datë 20.1.2021 të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi heqjen e

licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Sang 1” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Shoqëria “Sang 1” sh.p.k. është mbajtëse e licencës, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me nr. 443, seria P19, dhënë me vendimin e Bordit nr. 83, datë 31.5.2019, nga HEC “Thirrë” me kapacitet të instaluar 1.820 mw, për një afat 30-vjeçar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 107, datë 26.6.2019, “Për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 31.5.2019, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘SANG 1’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Thirrë’ me kapacitet të instaluar 1.820 mw’” ka vendosur:

- Pika 2, e vendimit nr. 83, datë 31.5.2019, ndryshon dhe bëhet:

“- Shoqëria “Sang 1” sh.p.k., të depozitojë në ERE:

2.1 Lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor nr. 97 prot., datë 8.5.2017, përpara datës 27.4.2022;

2.2 Dokumentacion që vërteton mbështetjen financiare të shoqërisë për ndërtimin e impiantit prodhues, brenda 3 muajve nga marrja dijeni e këtij vendimi.”.

- Duke qenë se në përfundim të afatit të vendosur me vendimin nr. 107/2019, nuk rezultoi që të ishte depozituar në ERE dokumentacioni përkatës, me shkresën nr. 124/12 prot., datë 20.11.2019, iu kërkua shoqërisë informacion në lidhje me ecurinë e plotësimit të kushtit të vendosur në pikën 2.2 të vendimit të sipërcituar dhe i ka kërkuar të dërgojë në ERE, deri më 26.11.2019, dokumentacion që vërteton mbështetjen financiare të shoqërisë për ndërtimin e impiantit prodhues.

Në vijim, për shkak të problematikës së ndeshur me komunikimin postar, për arsye se shkresa e dërguar shoqërisë është kthyer mbrapsht nga posta, ERE ka shfrytëzuar dhe shteruar të gjitha mënyrat e komunikimit zyrtar për të rivendosur komunikimin me shoqërinë, si *e-mail* dhe numrin e telefonit, ku i ka kërkuar asaj të saktësojë adresën e apo ashtu i ka kërkuar në mënyrë të përsëritur që të depozitojë dokumentacionin e munguar, në plotësim të kushtit të vendosur në vendimin nr. 107/2020.

- Sa konstatuar nga korrespondenca e zhvilluar në vijim me shoqërinë, rezulton që ajo nuk ka



depozituar ende në ERE dokumentacionin përkatës për të plotësuar kushtin e vendimit nr. 107/2020, pasi kontrata e sipërmarrjes, e nënshkruar me shoqërinë “Lajthiza Invest” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit, dhe shoqërisë “Sang 1” sh.p.k., në cilësinë e investitorit, ashtu si kontrata e sipërmarrjes e nënshkruar me shoqërinë “Xhast” sh.p.k. e depozituar më herët, nuk përbën dokumentacion që vërteton aftësinë apo mbështetjen financiare të shoqërisë “Sang 1” sh.p.k., ku të shprehen qartë vlera monetare për financimin dhe realizimin e projektit të ndërtimit të HEC “Thirrë”.

- Nga këqyrja e ekstraktit të QKB-së së shoqërisë, ka rezultuar se janë shitur 79% e kuotave, në shkelje të parashikimit të pikës 6.2 të kushteve të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, ku përcaktohet se i licencuari duhet të marrë autorizimin e ERE-s përpara se të ndryshojë aksionarin apo ortakun që kontrollon interesat.

- Ka rezultuar e provuar se i licencuari nuk ka përmbushur në afat e po ashtu nuk ka vërtetuar se ka bërë të gjitha përpjekjet që varen nga vullneti i tij për të përmbushur kushtet e vendimit të licencimit nr. 83/2019, të ndryshuar.

- Po ashtu, shoqëria nuk ka kthyer përgjigje për faktin se si ka vepruar me zbatimin e detyrimeve ligjore për të marrë autorizimin e ERE-s, për ndryshimin e aksionarit që kontrollon interesat e shoqërisë.

- Në nenin 42, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenin 5, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, si dhe në pikën 6.1, germa “a”, të licencës nr. 443, seria P19, dhënë shoqërisë “Sang 1” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 31.5.2019, të ndryshuar, parashikohet se ERE heq një licencë kur i licencuari nuk përmbush më kushtet thelbësore të licencës së dhënë.

- Në zbatim të nenit 6, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, me fillimin e procedurës për heqjen e licencës, shoqëria “Sang 1” sh.p.k., nuk çlirohet nga detyrimi për të shlyer për llogari të ERE-s pagesat

rregullore për vitin 2020, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Me vendimin e Bordit nr. 171/2020, ERE ka miratuar pagesat e rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, për vitin 2020. Vendimi i sipërcituar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 202, datë 19.11.2020, dhe sipas pikës 3 të këtij vendimi, të licencuarit duhet të shlyejnë këtë pagesë jo më vonë se 30 ditë nga botimi në Fletoren Zyrtare të këtij vendimi. Për këtë detyrim shoqëria “Sang 1” sh.p.k. është njoftuar edhe me shkresën e ERE-s nr. 1226/130 prot., datë 27.11.2020.

- Nuk rezulton që shoqëria “Sang 1” sh.p.k. të ketë shlyer pagesën e rregullimit për vitin 2020, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, ndaj me marrjen e njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës, ajo duhet të shlyejë për llogari të ERE-s këtë pagesë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 443, seria P19, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Sang 1” sh.p.k., me vendimin e Bordit nr. 83, datë 31.5.2019, të ndryshuar.

2. Shoqëria mund të paraqesë argumentet e saj me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Shoqëria “Sang 1” sh.p.k. duhet të shlyejë për llogari të ERE-s pagesat rregullore, për vitin 2020, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 9, datë 20.1.2021

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
HEQJEN E LICENCËS NR. 447, SERIA
T19, PËR VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË
“SANG 1” SHPK, ME VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 106,
DATË 26.6.2019**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 42, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 5, germa “a”, të nenit 6 dhe të nenit 7, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; të pikës 5.1 dhe pikës 5.2, të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016, si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.1.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 9/8 prot., datë 20.1.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi heqjen e licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “SANG 1” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Shoqëria “SANG 1” sh.p.k. është mbajtëse e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nr. 447, seria T19, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 26.6.2019.

Nga këqyrja e ekstraktit të QKB-së së shoqërisë, ka rezultuar se janë shitur 79% e kuotave, në shkelje të parashikimit të pikës 5.2 të kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, ku përcaktohet se i licencuari duhet të marrë autorizimin e ERE-s përpara se të ndryshojë aksionarin apo ortakun që kontrollon interesat.

- Shoqëria nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës së ERE-s, për faktin se si ka vepruar me zbatimin e detyrimeve ligjore për të marrë autorizimin e ERE-s, për ndryshimin e aksionarit që kontrollon interesat e shoqërisë.

- Në nenin 42, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të nenin 5, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, si dhe në:

- pikën 5.1, të licencës nr. 447, seria T19, dhënë shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 26.6.2019, parashikohet se ERE heq një licencë kur i licencuari nuk përmbush më kushtet thelbësore të licencës së dhënë.

- Në zbatim të nenit 6, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, me fillimin e procedurës për heqjen e licencës, shoqëria “SANG 1” sh.p.k. nuk çlirohet nga detyrimi për të shlyer, për llogari të ERE-s, pagesat rregullatore për vitin 2020, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Me vendimin e Bordit nr. 171/2020, ERE ka miratuar pagesat e rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, për vitin 2020. Vendimi i sipërcituar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 202, datë 19.11.2020, dhe sipas pikës 3 të këtij vendimi, të licencuarit duhet të shlyejnë këtë pagesë jo më vonë se 30 ditë nga botimi në Fletoren Zyrtare të këtij vendimi. Për këtë detyrim, shoqëria “SANG 1” sh.p.k. është njoftuar, dhe me shkresën e ERE-s nr. 1226/130 prot., datë 27.11.2020.

- Nuk rezulton që shoqëria “SANG 1” sh.p.k. të ketë shlyer pagesën e rregullimit për vitin 2020, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, ndaj me marrjen e njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës, ajo duhet të shlyejë për llogari të ERE-s këtë pagesë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 447, seria T19, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 26.6.2019.

2. Shoqëria mund të paraqesë argumentet e saj me shkrim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.



3. Shoqëria “SANG 1” sh.p.k. duhet të shlyejë, për llogari të ERE-s, pagesën rregullatore për vitin 2020, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative, Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 11 , datë 20.1.2021

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “GERTI”
SHPK NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “e”, të nenit 5, pika 1, germa “e”, të nenit 10, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 9/5 prot., datë 15.1.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë “Gerti” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Gerti” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 5 prot., datë 6.1.2021,

ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria “Gerti” sh.p.k., është regjistruar pranë QKB-së në datën 17.3.2000, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” (QKB) me statusin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.).

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Nga analiza e dokumentacionit, në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “Gerti” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germa: “a”, “b” dhe “c”, plotësuar;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germa: “c”, “e”, plotësuar;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germa: “b”, “d”, plotësuar.

- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

Nenin 9, pika 2, dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor:

- germa “a”/“b” (akti i themelimit/statuti), pa plotësuar. Shoqëria “Gerti” sh.p.k. në vijim do të depozitojë aktin e themelimit dhe statutin e saj në ERE;

- germa “d” (vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë). Plotësuar pjesërisht. Sa konstatuar në ekstraktin e QKB-së, shoqëria veprimtarinë e saj e ushtron edhe në zonën e Librazhdit (zona ku do të zhvillohet projekti i HEC Vardari). Si e tillë, kjo shoqëri, përveç vërtetimeve të gjendjes gjyqësore të lëshuara nga qarku i Dibrës (ku ndodhet selia kryesore e saj), duhet të përcjellë në ERE edhe ato të qarkut të Elbasanit.

Në vijim shoqëria do të depozitojë në ERE vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë së qarkut Dibër për administratorin e saj dhe vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë së qarkut Elbasan, për vetë shoqërinë dhe administratorin e saj.



Neni 9, pika 3, dokumentacioni financiar dhe fiskal:

- germa “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj institucionit të Sigurimeve Shoqërore). Plotësuar pjesërisht. Shoqëria në vijim do të përcjellë në ERE vërtetimin në lidhje me sigurimet shëndetësore dhe shoqërore;
- germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.). Plotësuar pjesërisht. Duke qenë se kjo shoqëri është aplikante edhe për prodhimin e energjisë elektrike, do t'i kërkohej të specifikojë kapitalin financiar që dedikon për tregtimin e energjisë elektrike.

Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8:

- germat: “a”/“d” (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t'u tregtuar në gwh/sipas viteve);
- germa “b” (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti);
- germa “c” (lista e kontratave të mëparshme, nëse ka pasur);

do të njoftohet subjekti, që në bazë të neneve 10, pika 10 dhe 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t'i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Gerti” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 12, datë 20.1.2021

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE- s, NË LIDHJE ME KËRKESËN E SHOQËRISË “SEMAN SUNPOWER” SHPK, PËR TRANSFERIM TË ASETVE (VENDOSJE HIPOTEKE) NË FAVOR TË “INTESA SANPAOLO BANK” SHA

Në mbështetje të nenit 16, të nenit 20, germa “a”, të nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; pikat 1.3, dhe 1.6 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; të nenit 7 dhe të nenit 11, pika 1, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.7.2016; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.1.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 9/1 prot., datë 14.1.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi zgjatjen e vendim marrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k., për transferim të aseteve në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a.,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 189, datë 19.11.2020, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k. për transferim të aseteve (vendosje hipoteke), në favor të “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a.

- Në vijim të sa më sipër, ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 1163/1 prot., datë 11.12.2020, duke i njoftuar fillimin e procedurës, dhe i kërkoj plotësimin e dokumentacionit të munguar nga aplikimi i saj.

- Me shkresën nr. 3 prot., datë 14.1.2020, shoqëria ka paraqitur në ERE kërkesën për shtyrje të afatit, për plotësimin e dokumentacionit, për arsye se ajo e ka pasur të pamundur të plotësojë në afat dokumentacionin e konstatuar të munguar për



shkak të periudhës së pandemisë *COVID-19*, e cila ka shfaqur pengesa për të vazhduar me ndjekjen e procedurave pranë institucioneve për dokumentacionin e kërkuar, kohës së zgjatur të pushimeve në ndërrimin e viteve, si dhe vonesave të shkaktuara për marrjen e dokumentacionit nga banka e cila ka financuar projektin, për ta paraqitur pranë ERE-s.

- Në nenin 10, pika 3, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve të të licencuarve”, përcaktohet se në rastin e transferimit të aseteve nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike me kapacitet më të madh se 10 mw, apo nga centralet në sektorin e gazit me vlerë më të madhe se 2.000.000.000 lekë, afati i përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, është 60 ditë sektorin e, ndaj për kërkesën e shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k. Bordi duhet të marrë vendimin përfundimtar brenda datës 21.1.2021

- Në nenin 53, pika 3, të “Kodit të procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë” përcaktohet se:

“- Afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.”.

- Duke qenë se kërkesa e shoqërisë, për zgjatje të afatit të depozitimit të dokumentacionit përkatës, është bërë e arsyetuar dhe përpara mbarimit të afatit për vendimmarrjen përfundimtare të Bordit të ERE-s, vlerësojmë se kërkesa e saj duhet të pranohet dhe të zgjatet afati i trajtimit final të praktikës me 30 ditë pune.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 30 ditë pune afatin e vendimmarrjes në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Seman Sunpower” shpk., për transferim të aseteve (vendosje hipoteke) në favor të “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë,

brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 17, datë 20.1.2021

MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË FILLUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 230, DATË 15.12.2020, “MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 415, SERIA P18K, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË ‘BLAC ENERGY’ SHPK ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 157, DATË 9.7.2018”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 95, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 8 dhe 9, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; si dhe të nenit 16, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.1.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 9/10 prot., datë 16.1.2021, të përgatitur nga Grupi i punës, “Mbi përfundimin e procedurës administrative të filluar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 230, datë 15.12.2020, ‘Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 415, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Blac Energy’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 157, datë 9.7.2018”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 230, datë 15.12.2020, vendosi për fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 415, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,



dhënë shoqërisë “Blac Energy” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 157, datë 9.7.2018.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 230, datë 15.12.2020, i është dërguar për dijeni shoqërisë “Blac Energy” sh.p.k. nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1172/9-1 prot., datë 23.12.2020.

- Në vijim të këtij njoftimi, në datën 13.1.2021, nga verifikimet e Drejtorisë së Financës në ERE, rezultoi dhe u bë me dije se janë shlyer detyrimet për pagesat e rregullimit për të cilat rezulton debitore shoqëria.

- Referuar afateve të përcaktuara nga ERE në njoftimin e dërguar për dijeni të subjektit, rezulton se subjekti ka shlyer detyrimet e prapambetura brenda afatit të përcaktuar në këtë njoftim e të sanksionuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 230/2020.

- Për sa më sipër, rezulton se shoqëria “Blac Energy” sh.p.k. nuk është debitore ndaj ERE-s për pagesat e prapambetura të rregullimit.

- Në nenin 8, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se: Pas marrjes së përgjigjes më shkrim nga i licencuari, sipas parashikimeve, personat e ngarkuar që ndjekin këtë procedurë do të shqyrtojnë këtë përgjigje brenda 30 ditëve dhe do të përgatisin një relacion për Bordin mbi argumentet e paraqitura dhe veprimet e ndërmarra nga i licencuari dhe do t’i propozojnë Bordit: a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës, në rast se i licencuari dëshmon mungesën e kushteve të përcaktuara në pikat: “a”, “b”, “c”, “ç” dhe/ose “d”, të nenit 5, të kësaj rregulloreje.

- Në nenin 95, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.

- Dispozitat e nenit 95 zbatohen për çdo procedurë administrative, pavarësisht nëse është filluar kryesisht nga organi publik ose me kërkesë të palës. Në këtë rast “qëllimi” i procedurës lidhet ngushtësisht me marrjen e masave ligjore, kryesisht nga organi që ka kompetencën, me qëllim shmangien e faktorit që ka nxitur vendimarrjen.

- Vërtetimi i shlyerjes së pagesave të prapambetura fakton ndryshimin e statusit të subjektit të cilit i kundrejtohet masa administrative, duke rezultuar në rënien e shkakut që imponoi marrjen e masës ligjore.

- Në nenin 9, germa “a”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë: a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës administrative të filluar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 230, datë 15.12.2020, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 415, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Blac Energy” sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 157, datë 9.7.2018”.

2. Shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 230, datë 15.12.2020, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 415, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Blac Energy” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 157, datë 9.7.2013”.

3. Grupi i Punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 18, datë 20.1.2021

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS
ADMINISTRATIVE TË FILLUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR.
235, DATË 15.12.2020 “MBI FILLIMIN E
PROCEDURËS PËR HEQJEN E
LICENCËS NR. 369, SERIA TGN17, PËR
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
GAZIT NATYROR, DHËNË SHOQËRISË
“C.G.C” SHPK, ME VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 73,
DATË 16.5.2017**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 95, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neneve 8 dhe 9 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017, si dhe nenit 16 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.1.2021, pasi shqyrtoi relacionin nr. 9/9 prot., datë 16.1.2021, të përgatitur nga grupi i punës, “Mbi përfundimin e procedurës administrative të filluar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 15.12.2020 ‘Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 369, seria TGN17, për veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror, dhënë shoqërisë ‘C.G.C’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 16.5.2017””,

KONSTATOI SE:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 235, datë 15.12.2020, vendosi për fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 369, seria TGN17, për veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror, dhënë shoqërisë “C.G.C” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE nr. 73, datë 16.5.2017.

- Vendimi i Bordit të ERE nr. 235, datë 15.12.2020, i është dërguar për dijeni shoqërisë C.G.C sh.p.k., nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1172/11-1 prot., datë 23.12.2020.

- Në vijim të këtij njoftimi, më datë 13.1.2021, nga verifikimet e Drejtorisë së Financës në ERE rezultoi dhe u bë me dije se, janë shlyer detyrimet për pagesat e rregullimit për të cilat rezulton debitore shoqëria.

- Referuar afateve të përcaktuara nga ERE në njoftimin e dërguar për dijeni të subjektit, rezulton se subjekti ka shlyer detyrimet e prapambetura brenda afatit të përcaktuar në këtë njoftim e të sanksionuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235/2020.

- Për sa më sipër, rezulton se shoqëria “C.G.C” sh.p.k. nuk është debitore ndaj ERE-s për pagesat e prapambetura të rregullimit.

- Në nenin 8 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se: pas marrjes së përgjigjes më shkrim nga i licencuari sipas parashikimeve, personat e ngarkuar që ndjekin këtë procedurë, do të shqyrtojnë këtë përgjigje brenda 30 ditëve dhe do të përgatisin një relacion për Bordin mbi argumentet e paraqitura dhe veprimet e ndërmarra nga i licencuari dhe do t'i propozojnë Bordit: a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës në rast se i licencuari dëshmon mungesën e kushteve të përcaktuara në pikat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe/ose “d”, të nenit 5, të kësaj rregulloreje.

- Në nenin 95 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”.

- Dispozitat e nenit 95 zbatohen për çdo procedurë administrative, pavarësisht nëse është filluar kryesisht nga organi publik ose me kërkesë të palës. Në këtë rast, “qëllimi” i procedurës lidhet ngushtësisht me marrjen e masave ligjore kryesisht nga organi që ka kompetencën, me qëllim shmangien e faktorit që ka nxitur vendimmarrjen.

- Vërtetimi i shlyerjes së pagesave të prapambetura, fakton ndryshimin e statusit të subjektit të cilit i kundërdrejtohet masa administrative duke rezultuar në rënien e shkakut që imponoi marrjen e masës ligjore.

- Në nenin 9, germa “a”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e



energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se: “Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas neneve 7 dhe 8, të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë: a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës administrative të filluar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 15.12.2020, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 369, seria TGN17, për veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror, dhënë shoqërisë ‘C.G.C’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 16.5.2017”.

2. Shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 235, datë 15.12.2020, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 369, seria TGN17, për veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror, dhënë shoqërisë ‘C.G.C’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 16.5.2017”.

3. Grupi i punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 21, datë 25.1.2021

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA HEC “PISHAT”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1991 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”, të nenit 5, pika 1, germa “a” dhe të

nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.1.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 13/1 prot., datë 19.1.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë “Greentech Energy Systems” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 184, datë 13.11.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Greentech Energy Systems” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Pishat”, me vendndodhje në përronin e Holtës, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, me “Njoftimin për licencim” nr. 62/37 prot., datë 16.11.2020, u krye njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Greentech Energy Systems” sh.p.k.

- Me shkresën nr. 1155/1 prot., datë 24.11.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar. Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1155/2 prot., datë 17.12.2020, shoqëria ka paraqitur kërkesën për shtyrje të afatit për plotësimin e dokumentacionit, për arsye se shkresa e ERE-s nr. 1155/1 prot., datë 24.11.2020 (kërkesë e bërë përpara përfundimit të afatit për vendimmarrjen përfundimtare të Bordit të ERE-s), është dërguar në adresën qendrore të shoqërisë, në Poroçan, dhe personi që e ka marrë në dorëzim, duke qenë i infektuar me COVID-19, nuk ia ka dorëzuar në kohë, çka ka bërë që shoqëria të mos ketë kohën e mjaftueshme për të plotësuar dokumentacionin e kërkuar.



- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 245, datë 21.12.2020, vendosi të zgjasë me 30 ditë pune afatin e vendimarrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Greentech Energy Systems” sh.p.k për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Kjo vendimarrje ju njoftua shoqërisë me shkresën nr. 1155/3 prot., datë 23.12.2020.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “Greentech Energy Systems” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 3 prot., datë 6.1.2021, ka paraqitur tërësisht dokumentacionin e munguar sipas formës së kërkuar nga rregullorja e licencimit.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë prodhimi të energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Dokumentacioni i këtij aplikimi në fazën finale të miratimit të tij, është tërësisht i plotësuar si vijon:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat: “a”, “b”, “c”. Plotësuar;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”. Plotësuar;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat: “a”, “b”, “c”, “d”. Plotësuar;

- Dokumentacioni teknik për HEC, neni 9, pika 4.1.1, “Të dhëna teknike për HEC”; pika 4.1.2 “Të dhëna teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin”; pika 4.1.3 “Dokumentacioni teknik dhe grafik”; pika 4.1.4 “Dokumentacioni tekniko-ekonomik”, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe pika 4.1.5, “Leje nga institucionet e tjera”, germat: “a”, “b”, “c”. Plotësuar.

- Në përfundim të afatit të kontratës së qirasë me Bashkinë Gramsh (data e përfundimit 5.4.2027), shoqëria duhet ta depozitojë atë me afate të rinovuara, një muaj pas nënshkrimit të rinovimit.

- Në përfundim të afatit të lejes së përdorimit të burimit ujor (data e përfundimit 11.5.2022), do t’i kërkohej shoqërisë ta depozitojë atë me afate të rinovuara një muaj pas rinovimit.

- Kontrata nr. 2513 rep., nr. 1180 kol., datë 3.11.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Pishat’, e lidhur midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Mbajtësit të Miratimit, shoqërisë “Greentech Energy Systems” sh.p.k., ka një afat

49- vjeçar, por nga ana tjetër shpjegojmë se ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe të nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk mund të japë, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Greentech Energy Systems” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Pishat”, me kapacitet të instaluar 1911 kW, për një afat 30-vjeçar.

2. Në përfundim të afatit të kontratës së qirasë me Bashkinë Gramsh (data e përfundimit 5.4.2027), shoqëria duhet ta depozitojë atë me afate të rinovuara, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit.

3. Në përfundim të afatit të lejes së përdorimit të burimit ujor (data e përfundimit 11.05.2022), shoqëria “Greentech Energy Systems” sh.p.k. duhet ta dorëzojë atë me afate të rinovuara jo më vonë se një muaj pas rinovimit.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 22, datë 25.1.2021

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS
ADMINISTRATIVE TË NISUR ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR.
183, DATË 13.11.2020, “MBI FILLIMIN E
PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E
SHOQËRISË ‘GREENTECH ENERGY
SYSTEMS’ SHPK NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 64, pika 2 dhe të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të nenit 15, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 13/2 prot., datë 19.1.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin nr. 183, datë 13.11.2020,

konstatoi se:

- Shoqëria “Greentech Energy Systems” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1155 prot., datë 2.11.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 183, datë 13.11.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Greentech Energy Systems” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, me “Njoftimin për licencim” nr. 62/35 prot., datë 16.11.2020, u krye njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo

ankesa nga palët e treta lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Greentech Energy Systems” sh.p.k.

- Me shkresën nr. 1155/1 prot., datë 24.11.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar në këtë aplikim.

- Shoqëria “Greentech Energy Systems” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1155/2 prot., datë 17.12.2020, ka paraqitur kërkesën për shtyrje të afatit për plotësimin e dokumentacionit, për arsye se shkresa e ERE-s nr. 1155/1 prot., datë 24.11.2020 (kërkesë e bërë përpara përfundimit të afatit për vendimmarrjen përfundimtare të Bordit të ERE-s), është dërguar në adresën qendrore të shoqërisë, në Poroçan, dhe personi që e ka marrë në dorëzim, duke qenë i infektuar me COVID-19, nuk ia ka dorëzuar në kohë, çka ka bërë që shoqëria të mos ketë kohën e mjaftueshme për të plotësuar dokumentacionin e kërkuar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 245, datë 21.12.2020, vendosi të zgjasë me 30 ditë pune afatin e vendimmarrjes në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Greentech Energy Systems” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Kjo vendimmarrje iu njoftua shoqërisë me shkresën nr. 1155/3 prot., datë 23.12.2020.

- Shoqëria “Greentech Energy Systems” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 3 prot., datë 6.1.2021, ka bërë me dije se: “për sa i përket aplikimit për licencë për tregtim të energjisë elektrike heqim dorë për momentin”.

- Neni 64, i “Kodit të Procedurave Administrative”, në pikën 2 parashikon se:

“- Një palë, me anë të një kërkesë me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dorë nga të drejtat dhe interesat e saj ligjore, përveç rasteve kur kjo ndalohet me ligj.

- Pas tërheqjes së një pale, organi publik vendos përfundimin e procedurës administrative.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 183, datë 13.11.2020, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Greentech Energy Systems’



sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”.

2. Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 183, datë 13.11.2020, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Greentech Energy Systems’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, shfuqizohet.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 23, datë 25.1.2021

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ES 2019” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “e”, të nenit 5, pika 1, germa “e”, të nenit 8, pika 3 dhe të nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.1.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 13/3 prot., datë 19.1.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘ES 2019’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 243, datë 21.12.2020, filloi procedurën për licencimin e

shoqërisë “ES 2019” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje u krye njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “ES 2019” sh.p.k.

- Shoqëria “ES 2019” sh.p.k. ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Dokumentacioni i këtij aplikimi është i plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “ES 2019” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 24, datë 25.1.2021

**MBI KËRKESËN E OSSH SHA, LIDHUR
ME PËRDORIMIN E VLERAVE
ZËVENDËSUESE TË KONSUMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE PËRGJATË
PERIUDHËS SË ZBATIMIT TË MASAVE
PARANDALUESE NDAJ COVID-19**

Në mbështetje të neneve 6, 16, 19 dhe 20, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 243, datë 24.3.2020, “Për shpalljen e fatkeqësisë natyrore”; të VKM-së nr. 8, datë, 24.3.2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij nr. 4, të datës 25.1.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 13/7 prot., datë 22.1.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve, mbi kërkesën e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.), lidhur me përdorimin e vlerave zëvendësuese të konsumit të energjisë elektrike përgjatë periudhës së zbatimit të masave parandaluese ndaj COVID-19,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s vendosi për marrjen e masave të përkohshme me vendimin nr. 58/2020, “Mbi përcaktimin e mënyrës së faturimit të energjisë elektrike, gjatë periudhës së zbatimit të aktit normativ të Këshillit të Ministrave nr. 8, datë 24.3.2020, Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19”, të ndryshuar”, si dhe të VKM-së nr. 243, datë 24.3.2020, “Për shpalljen e fatkeqësisë natyrore”.

- OSSH sh.a. iu drejtua ERE-s me një tjetër komunikim shkresor me nr. 307 prot., datë 13.1.2021, duke kërkuar miratimin e implementimit

të leximit periodik dymujor për një periudhë 12-mujore.

- Vendimarrja e përkohshme e Bordit të ERE-s përmes vendimit nr. 58/2020, krijoi kushtet për OSSH sh.a., që në rrethanat e kufizimeve të lëvizjes së lirë por edhe me qëllim mbrojtjen e punonjësve të tij, të kryejë leximin e matësve njëherë në 3 muaj, duke faturuar përgjatë kohëzgjatjes së efekteve juridike të këtij vendimi, konsumin e energjisë elektrike të së njëjtut muaj të vitit paraardhës. Në muajin e fundit të kohëzgjatjes së këtij vendimi, OSSH sh.a. procedoi me leximin e matësit e lëshimin e faturës korrigjuese, duke iu referuar të dhënave reale të matjes.

- Zbatimi me korrektesë i vendimarrjes së mësipërme, ishte në vëmendjen e ERE-s, i cili kërkoj nga FSHU sh.a. informacion në lidhje me numrin e ankesave të regjistruara përgjatë kohës së shtrirjes së efekteve juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 58/2020.

- Në vijim të analizës së të dhënave të ankesave të regjistruara pranë FSHU sh.a., për faturim me vlerë referuese sipas vendimit nr. 58, datë 26.3.2020, rezulton se ky numër ka pasur një rënie të ndjeshme, duke shënuar 114 ankesa të regjistruara në muajin qershor.

- Shtrirja e këtyre modaliteteve të leximit do të ndihmojë OSSH sh.a., por edhe FSHU sh.a. në krijimin e një pasqyre më të qartë në lidhje me efektet apo impaktin që krijon realisht kjo mënyrë e re leximi disamujore edhe në përmbushje të detyrave të lëna nga rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë, e cila ka parashikuar që ERE të caktojë afate konkrete për OSSH-në dhe FSHU-në për vënien sa më shpejt në punë të sistemit të ri të faturimit, të paktën në disa projekte pilot të identifikuar nga vetë OSSH sh.a., i cili lehtëson në mënyrë të ndjeshme leximin e matjes së energjisë, krijon mundësi dhe opsione të reja duke përfshirë edhe leximin periodik disamujor.

- Propozimi i OSSH sh.a., për shtrirjen e efekteve të kësaj mënyre leximi 2-mujore, për një periudhë 1-vjeçare, është përtej nevojës së parashikueshme për implementimin e saj, duke vlerësuar se vetë impakti i pandemisë në popullatë përgjatë periudhës së verës, gjatë vitit 2020, ishte relativisht më i ulët, e për rrjedhojë gjykojmë se implementimi i këtij propozimi për një periudhë 6-mujore, është i mjaftueshëm për të kënaqur nevojat e OSSH sh.a. në kushtet e pandemisë, por edhe



duke prodhuar rezultate të analizueshme të tilla që mund të çojnë në zgjatjen e efekteve të këtij propozimi apo vlerësimin e implementimit të këtyre modaliteteve të leximit të matësve për kohëzgjatje më të mëdha.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë modalitetet e faturimit dhe të leximit të energjisë elektrike, për një periudhë 6-mujore nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, si më poshtë:

2. Faturimin e klientëve të energjisë elektrike (familjarë dhe jofamiljarë), duke filluar që nga cikli i leximit të muajit janar 2021 deri në ciklin e leximit të muajit qershor 2021, sipas përcaktimeve të mëposhtme:

2.1 Të gjithë klientët aktivë të kategorisë familjare/jofamiljare, do të faturohen me vlerë referuese zëvendësuese me të njëjtin konsum të muajit përkatës të vitit 2020, dhe në muajin pasardhës, faturimi do të kryhet mbi bazën e leximit të matësit dhe korrigjimin e faturës së muajit paraardhës, nëse konstatohet rrethana. Nga kjo dispozitë përjashtohen kategoritë e klientëve si më poshtë:

a) që në muajin e faturimit me vlerë referuese, kanë faturim 0 kWh në muajin respektiv të vitit paraardhës;

b) kanë ankesë për mbifaturim të energjisë elektrike për muajt për të cilët do të përdoret referenca;

c) kanë bërë ose do të bëjnë kërkesë për pezullim/mbyllje të kontratave të energjisë elektrike në proces, pa hequr detyrimin e OSSH sh.a. për vazhdimin e procedurës së pezullimit/mbylljes së kontratave sipas legjislacionit në fuqi.

2.2. Për kontratat e furnizimit me energji elektrike që nuk kanë faturime të muajit referues të vitit të mëparshëm të konsumit me matje të energjisë elektrike, faturimi me vlera referuese të bëhet bazuar në mesataren e konsumit me matje të energjisë elektrike, të regjistruar gjatë vitit të fundit në sistemin e faturimit.

2.3 Për të gjithë klientët me matje *online*, procesi i leximit dhe faturimit të vazhdojë i pandryshueshëm.

3. Leximi i matësve të energjisë elektrike për të gjithë kategoritë e klientëve aktiv (familjarë dhe

jofamiljarë) do të bëhet në muajin pasardhës të muajit të faturimit me vlerë referuese, dhe nëse konstatohet rrethana do të bëhet korrigjimi në muajin pasardhës duke marrë në konsideratë vlerat e leximit të matësit.

4. Të gjithë klientët që furnizohen në tregun e parregulluar ose ata që do të fillojnë të furnizohen me energji elektrike në tregun e rregulluar apo të parregulluar, gjatë kohëzgjatjes së efekteve juridike të këtij vendimi, përjashtohen nga parashikimet e pikës 2 të këtij vendimi.

5. Faturimi i konsumit të ambienteve të përbashkëta të vazhdojë i njëjtë për të gjithë kategoritë e klientëve që iu ofrohet ky shërbim.

6. Faturimin e tarifës së shërbimit (përfshirë TVSH-në) për të gjithë klientët familjarë dhe jofamiljarë me konsum 0 kWh.

7. Kur klienti dokumenton moskonsumim të energjisë elektrike gjatë periudhës së faturimit, objekt i këtij vendimi, OSSH sh.a. është e detyruar të bëjë leximin dhe verifikimin e matësit për këta klientë. FSHU sh.a. do të faturojë këta klientë në bazë të leximeve me matje.

8. Diferencat që do të rezultojnë ndërmjet faturimit me vlerë referuese, zëvendësuese sipas këtij vendimi, dhe vlerës reale të konsumit të lexuar në muajin e dytë do të sistemohen brenda muajit pasardhës.

9. Raportimin në ERE, brenda datës 20 të çdo muaji kalendarik, të të gjithë ankesave të klientëve që do të rezultojnë nga aplikimi i kësaj mënyre faturimi, dhe zgjidhjen e tyre brenda një periudhe 20-ditore nga regjistrimi i ankesës duke mbajtur në konsideratë kushtin e pranimi të ankesave *online* dhe në sportelet e kujdesit të klientit vetëm sipas rregullave të përcaktuara, sipas protokollit të Autoriteteve të Shëndetësisë, planit të masave të ndërmarra në vendin tonë për ndalimin e përhapjes së pandemisë, si dhe akteve normative për ruajtjen e distancave ndërmjet personave.

10. Pezullimin e përkohshëm të parashikimeve të nenit 11.1, të “Kushteve të përgjithshme të kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për klientët fundorë”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 15, datë 10.1.2018, përgjatë kohëzgjatjes së këtij vendimi, për kategoritë e parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi.

11. OSSH sh.a. dhe FSHU sh.a. të raportojnë, brenda datës 20 të çdo muaji kalendarik, përgjatë



kohëzgjatjes së këtij vendimi, në lidhje me ecurinë e zbatimit të këtij vendimi.

12. OSSH sh.a. dhe FSHU sh.a. të marrë të gjitha masat për publikimin e këtij vendimi në faqen e internetit të shoqërisë, si dhe në median elektronike e të shkruar për sa është e mundur dhe të njoftojë ERE-n për këtë.

13. Ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve për njoftimin e palëve të interesit mbi këtë vendimarrje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendrike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendrike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM
Nr. 25, datë 25.1.2021

**MBI APLIKIMIN E SHOQËRISË OSSH
SHA PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË
SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE, NË NIVEL
TENSIONI, PËR VITIN 2021**

Në mbështetje të nenit 16, të nenit 19, të nenit 20, germa “c”, dhe të nenit 21, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar, dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “c”, dhe pika 3, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 25.1.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 13/5 prot., datë 22.1.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, mbi aplikimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.)

për miratimin e tarifës së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, në nivel tensioni, për vitin 2021,

konstatoi se:

- ERE, ndër të tjera, bazuar në përcaktimet e nenit 19, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, është institucioni përgjegjës për miratimin në përputhje me parimin e transparencës, të kostos së shërbimit të ofruar të tarifave për veprimtaritë e licencuara, për të cilat është vendosur detyrimi i shërbimit publik.

- Shoqëria OSSH sh.a., me shkresën nr. 9811 prot., datë 23.12.2020 (protokolluar në ERE me nr. 1308 prot., datë 28.12.2020), ka paraqitur aplikimin për tarifën e OSSH sh.a., për nivel tensioni, për vitin 2021.

- Shoqëria OSSH sh.a., në aplikimin e saj, ka propozuar një tarifë mesatare të shpërndarjes së energjisë elektrike prej 5.98 lekë/kwh, nga 4.79 lekë/kwh të miratuar nga ERE, për vitin 2015, dhe e mbajtur në fuqi edhe për periudhën 2016–2020, si dhe tarifën sipas nivelit të tensionit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2021, si më poshtë vijon:

a) tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike në tension 35 kV – 3.70 lekë/kwh;

b) tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike në tension 6 – 20 kV – 4.00 lekë/kwh;

c) tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike në tension 0.4 kV – 6.30 lekë/kwh.

Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, rezulton se OSSH sh.a., për qëllime të këtij aplikimi, ka paraqitur:

- Një informacion të përgjithshëm dhe deklarime rreth aktivitetit të shpërndarjes, duke listuar përgjegjësitë kryesore të saj të cilat burojnë nga aktet ligjore, nënligjore dhe ato rregullatore në fuqi, duke cilësuar dhe kostot që tarifën e shpërndarjes synojnë të shlyejnë;

- Në aplikim u konstatua se janë paraqitur vetëm vlera të komponentëve të të ardhurave të kërkuara, të pa shoqëruara me shpjegime, analiza dhe dokumentacion shoqëruar, për secilin zë të këtyre shpenzimeve;

- OSSH sh.a. si vit testimi konsideron vitin 2020, i cili tashmë është i mbyllur dhe shoqëria disponon të dhënat mbi realizimin e çdo treguesi teknik, ekonomik dhe financiar por nuk pasqyron dhe argumenton të dhëna mbi shpenzimet dhe të



ardhurat, si dhe tarifat e aplikuara/realizuara për çdo nivel tensioni.

Në zbatim të përcaktimeve të “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, për qëllime të këtij aplikimi nga OSSH sh.a., konstatohet se:

- Shoqëria nuk ka paraqitur në mënyrë analitike secilin grup shpenzimi të OPEX-it, si dhe nuk ka argumentuar realizimin faktik të tyre sipas periudhave ushtrimore tashmë të mbyllura, si dhe parashikimet e këtyre shpenzimeve për periudhat e ardhshme rregullatore.

- Shoqëria ka paraqitur të dhëna mbi realizimin e treguesve financiarë dhe ekonomikë për 10-mujorshin e 2020-ës, si dhe parashikimin e tyre për vitin 2020, por nuk ka përcjellë pasqyrat financiare operative për këtë periudhë, në mënyrë të veçantë pasqyra e performancës ku duhet të evidentohen në formë analitike shpenzimet e realizuara për secilin zë të OPEX-it.

- Aplikimi nuk është i shoqëruar me të dhëna analitike në përputhje me “Sistemin e njehsuar dhe të standardizuar të llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, për aktivitetet e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizuesit të shërbimit universal të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 244, datë 26.11.2018.

- Nuk mundësohet kryerja e vlerësimeve dhe analizave nëse është adaptuar shmangia e ndërsuvencionimit midis aktiviteteve të shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike, mbështetur në përcaktimet e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe ndarja efektive e llogarive të aktiviteteve të licencuara.

- Në aplikim konstatohen vetëm deklaramë dhe tabela të pashoqëruara me argumente, sqarime apo dokumentacion mbi: i. shpenzimet operative dhe alokimin e tyre; ii. koston e borxhit; iii. kostot e tjera të përfshira në tarifë; iv. kreditë e marra në periudhat e mëparshme apo dhe kreditë e parashikuara për vitin 2021; v. korrigjimin e të ardhurave të kërkuara, etj.

- OSSH sh.a. nuk ka paraqitur të dhëna të mjaftueshme për të gjykuar mbi saktësinë e llogaritjes së Kostos Mesatare të Ponderuar të Kapitalit (WACC), si dhe vlerësime mbi pranimet lidhur me secilin komponentë të WACC.

- Të dhënat e paraqitura në aplikim, lidhur me AROE-n, janë të ndryshme nga ato të publikuara në të njëjtin burim (*link*), duke krijuar pasiguri mbi kryerjen e vlerësimeve të drejta për llogaritjen e kthimit të lejuar mbi kapitalin e vet të përdorur nga OSSH sh.a., e si rrjedhojë dhe në përllogaritjen e WACC në tërësi.

- Nuk jepet informacion sqarues mbi kreditë e shoqërisë, si pjesë e borxhit të ri dhe të vjetër (plan amortizimi, norma interesi etj.), si dhe se çfarë përfshijnë vlerat e paraqitura në përllogaritjen e bazës së rregulluar të asetëve.

- Plani i investimeve nuk është paraqitur si një aplikim më vete dhe i mbështetur në përcaktimet e rregullores mbi “Procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 135, datë 6.9.2017.

- Nuk janë paraqitur të dhëna mbi bilancin e pikut koindues të fluksit të ngarkesës apo të shumës totale të të gjithë ngarkesave jokoinciduese për grupet e klientëve sipas nivelit të tensionit.

- Korrigjimi i të ardhurave të kërkuara nuk paraqet efektet e të ardhurave të realizuara nga ato të miratuara në periudhën paraardhëse, të cilat duhet të reflektohen në të ardhurat e kërkuara për vitin 2021, lidhur me aktivitetin e shpërndarjes, të cilat duhet të shoqërohen me dëshmi dhe prova për arsyet dhe nivelin e çdo korrigjimi/rregullimi, në zbatim të përcaktimeve të “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”.

- Aplikimi i shoqërisë OSSH sh.a., përgjithësisht, nuk përmbush kriteret e formës dhe të përmbajtjes, si dhe ka kryesisht mangësi në dhënie dhe shpjegimeve dhe dokumenteve justifikuese mbi aspekte të veçanta të komponentëve të të ardhurave të kërkuara sipas kërkesave të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, dhe të “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 182, datë 10.11.2017, si dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi.



VENDOSI:

1. Mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OSSH sh.a. lidhur me miratimin e tarifave të kërkuara, për nivel tensioni, për vitin 2021.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkolet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 26, datë 25.1.2021

**MBI APLIKIMIN E SHOQËRISË
FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL
SHA PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TË
SHËRBIMIT TË SHITJES ME PAKICË TË
ENERGJISË ELEKTRIKE, PËR VITIN 2021**

Në mbështetje të nenit 19, të nenit 20, germa “c”, të nenit 83 dhe të nenit 85, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar, dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa c, dhe pika 3, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 25.1.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 13/6 prot., datë 15.10.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, mbi aplikimin e shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU sh.a.) për miratimin e çmimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike, për vitin 2021,

konstatoi se:

- ERE, ndër të tjera, është autoriteti përgjegjës për miratimin e çmimeve të rregulluara për klientët fundorë që furnizohen sipas Shërbimit Universal të Furnizimit, sipas parashikimit të nenit 83, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 11641 prot., datë 22.12.2020 (protokolluar në ERE me nr. 1299 prot., datë 24.12.2020), ka paraqitur “Aplikimin për çmimin e shitjes me pakicë të energjisë elektrike, për vitin 2021”.

- Shoqëria FSHU sh.a., në aplikim, deklaroi se nga përlogaritjet e saj çmimi mesatar i shitjes së energjisë është pothuaj i njëjtë me atë në fuqi, duke propozuar si vijon:

1. Çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike, si dhe çmimet e detajuara sipas vendimit të Bordit të ERE-s nr. 148, datë 25.12.2014, të mos ndryshojnë.

2. Çmimi i shitjes për konsumatorët e lidhur në TM dhe me matës në TU, sipas vendimit të Bordit të ERE-s nr. 128, datë 29.7.2016, të mos ndryshojë.

3. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për kategorinë “Objekte kulturi, bashkësi fetare”, sipas vendimit të Bordit të ERE-s nr. 53, datë 6.4.2017, të mos ndryshojë.

Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, rezultoi se FSHU sh.a., për qëllime të këtij aplikimi, ka paraqitur si vijon:

- Një informacion të përgjithshëm që paraqet deklarime rreth aktivitetit të furnizimit të shërbimit universal, duke listuar përgjegjësitë kryesore të saj të cilat burojnë nga aktet ligjore, nënligjore dhe ato rregullatore në fuqi;

- Në aplikim u konstatua se janë paraqitur vetëm vlera të komponentëve të të ardhurave të kërkuara, të pa shoqëruara me shpjegime, analiza dhe dokumentacion shoqëruar për secilin komponent, duke mos i reflektuar/alokuar ato sipas kategorive të ndryshme të klientëve për çdo nivel tensioni, sipas përcaktimeve të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë të klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal”;

- Nga aplikimi konstatohet se FSHU sh.a. si vit testimi konsideron vitin 2020, i cili tashmë është i mbyllur dhe shoqëria disponon të dhënat mbi realizimin e çdo treguesi financiar dhe ekonomik,



në mënyrë të tillë që të paraqesë në formën e një raporti shpenzimet, të ardhurat dhe çmimet e aplikuara dhe të realizuara për çdo kategori klientësh përfshirë dhe ata të cilët janë të lidhur në TM, por me matje në TU, për periudhat e mëparshme ushtrimore, si dhe efektet e tyre të pritshme për vitin 2021.

Në zbatim të përcaktimeve të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë të klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”, për qëllime të këtij aplikimi, nga FSHU sh.a., konstatohet se:

- Shoqëria nuk ka paraqitur në mënyrë analitike, si dhe nuk ka argumentuar realizimin faktik të komponentëve të OPEX-it, lidhur me periudhat ushtrimore tashmë të mbyllura, si dhe parashikimet e këtyre shpenzimeve për periudhat e ardhshme rregullatore.

- Shoqëria ka paraqitur të dhëna mbi realizimin e treguesve financiarë dhe ekonomikë, për 10-mujorshin e 2020-ës, si dhe parashikimin e tyre për vitin 2020, por nuk ka përcjellë pasqyrat financiare operative për këtë periudhë, në mënyrë të veçantë pasqyra e performancës ku duhet të evidentohen në formë analitike shpenzimet e realizuara për secilin zë të OPEX-it.

- Aplikimi nuk është i shoqëruar me të dhëna analitike në përputhje me “Sistemin e njehsuar dhe të standardizuar të llogarive, për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, për aktivitetet e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizuesit të shërbimit universal të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 244, datë 26.11.2018.

- Bilanci energjetik duhet të reflektonte sasinë e energjisë së shitur në periudhat e mbyllura ushtrimore me ato të shitura në vitin e testimit, në mënyrë të tillë që të vlerësoheshin tendencat e sasisë së energjisë së shitur në rrjetin e shpërndarjes dhe asaj që parashikohet të shitet në periudhën e ardhshme rregullatore, të ndarë sipas kategorive të klientëve fundorë për secilin nivel tensioni ku operon FSHU sh.a.

- Nuk mundësohet një vlerësim i drejtë lidhur me kostot e aktivitetit të FSHU sh.a., meqenëse shoqëria nuk ka paraqitur llogaritë e ndara midis aktivitetit të Furnizimit të Shërbimit Universal nga ato të Furnizimit të Mundësisë së Fundit.

- Janë paraqitur deklarime dhe tabela të pashoqëruara me argumente, sqarime apo dokumentacion mbi: i. shpenzimet operative dhe alokimin e tyre; ii. kosto të tjera të përfshira në çmimet e shitjes së energjisë elektrike, sipas kategorive të klientëve, bazuar në përqindjet e energjisë së shitur për çdo kategori; iii. koston e borxhit të keq; iv. korrigjimin e të ardhurave të realizuara mbi/nën kërkesën e lejuar për të ardhura për vitin paraardhës, etj.

- Kompensimi për borxhin e keq është llogaritur në masën 5%, bazuar në përcaktimet e VKM-së nr. 253, datë 24.4.2019, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar, por kjo llogaritje nuk është paraqitur si normë e realizuar për secilin kategori klientësh sipas strukturës së shitjes dhe e ndarë për nivele tensioni.

- Aplikimi nuk është shoqëruar me listën e aktiveve materiale dhe jomateriale mbështetur në pasqyrat financiare, llogaritjet e amortizimit të akumuluar për periudhën 2015–2020, për asetet dhe shtesat sipas viteve të cilat i përkasin shoqërisë FSHU sh.a., si dhe lista e asetëve fikse të cilat do të transferohen nga shoqëria “mëmë” dhe do t’i shërbejnë shoqërisë FSHU sh.a. për ushtrimin e aktivitetit të licencuar.

- Mungojnë të dhëna apo vlerësime mbi të ardhurat e kërkuara për çdo kategori klientësh, në mbështetje të përcaktimeve të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë të klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”, të cilat duhet të krahasohen me të ardhurat e pritshme bazuar në nivelin aktual të çmimeve për çdo kategori klientësh.

- Mungojnë të dhëna lidhur me korrigjimin e të ardhurave të kërkuara në total për aktivitetin e saj, si asnjë korrigjim mbi të ardhurat e realizuara mbi/nën kërkesën e lejuar, për të ardhura për vitin paraardhës, e cila duhet të shpërndahet sipas kategorive të klientëve për nivele tensioni bazuar në përqindjet e shitjeve në kwh.

- Aplikimi i FSHU sh.a., përgjithësisht, nuk përmbush kriteret e formës dhe të përmbajtjes, si dhe ka kryesisht mangësi në dhënien e shpjegimeve dhe dokumenteve justifikuese mbi aspekte të



veçanta të komponentëve të të ardhurave, të kërkuara sipas kërkesave të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016 dhe të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë te klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”, të miratuar me vendimin nr. 189, datë 23.11.2017, të Bordit të ERE-s, si dhe të akteve të tjera nënligjore në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Mos fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë FSHU sh.a. për çmimin e shitjes së energjisë elektrike me pakicë, për vitin 2021.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË

Shtetasi Lulzim Metushi kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier shpalljen e zhdukjes së shtetasit Bardhul Metushi, nga muaji tetor 1991, dhe caktimin e tij si kujdestar për administrimin e pasurisë së tij, të luajtshme dhe të paluajtshme.

KËRKUES
Lulzim Metushi

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 208 lekë